REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.12.2022)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}", (relatore znj. Irena Plaku). ***(Shtyrë nga mbledhja plenare datë 02.11.2022).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:23 dhe mbaroi në orën 15:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Genta.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

8. {...}, magjistrate.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}", (relatore znj. Irena Plaku). ***(Shtyrë nga mbledhja plenare datë 02.11.2022).***

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 14 dhjetor.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot nga ana e Këshillit do të merren në shqyrtim 10 çështje.

Nëse nuk kemi diskutim mbi përmbajtjen e rendit, atëherë fillojmë me çështjen e parë. Dy çështjet e para në fakt kanë të bëjnë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, për gjyqtaren {...} dhe gjithashtu shqyrtimi i

projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares për vitin 2021, për efekt të kandidimit që ka bërë në Gjykatën e Lartë.

Nga ana e gjyqtares është kërkuar që të jetë e pranishme dhe të dëgjohet në shqyrtimin e projektvendimeve. Kështu që, pa humbur kohë, ftojmë magjistraten që të vijë në sallë.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje zonja {...}!

Siç jeni në dijeni, sot Këshilli i Lartë Gjyqësor do të marri në shqyrtim dy projektvendime që lidhen me vlerësimin tuaj etik dhe profesional. Bëhet fjalë fillimisht për projektvendimin e parë që ka të bëjë me periudhën e gradimit tuaj 2013–2016 dhe më pas kemi për 2021. Procedura që ne ndjekim në këtë lloj procesi, në vlerësimin e raportit, është që kur nga ana e magjistratit (gjyqtarit) kërkohet që të jetë i pranishëm në sallë, fjala fillimisht i jepet relatorit të projektvendimit (të raportit). Pasi relatori pasqyron shkurtimisht gjetjet e raportit të vlerësimit, më pas ju kalon fjala juve për të dhënë komentet apo kundërshtimet që keni mbi përmbajtjen e raportit. Pasi mbaroni edhe ju kundërshtimet, ju largoheni për të lejuar Këshillin për të marrë vendimmarrje mbi raportin e vlerësimit etik.

Kështu që, pa humbur kohë, unë dëshiroj që t'ia jap fjalën zonjës Plaku, e cila do jetë relatore për projektvendimin për vlerësimin etik dhe profesional, për qëllim gradimi (2013-2016).

Irena Plaku: Faleminderit Kryetare!

Atëherë, procedura e vlerësimit të gjyqtares {...}, ka filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 41, datë 04.02.2021, pas dërgimit të dosjeve me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: Relatore znj. {...}; Nëpunëse përgjegjëse znj. Zeta Tërpollari.

Me urdhrin e datës 15.04.2021, relatorja ka disponuar për zhvillimin e shortit. Bazuar në këtë urdhër është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) dosjeve.

Me vendimin nr. 14, datë 17.01.2022, "Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të papërfunduar për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}", është zëvendësuar relatorja {...}, dhe jam zgjedhur unë si relatore. Gjithashtu, me vendimin nr. 13, datë 17.01.2022 është zëvendësuar nëpunësja përgjegjëse duke u zëvendësuar me nëpunësen znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtarja është njoftuar rregullisht për të gjithë procedurën, duke shprehur edhe dakordësinë si për relatoren dhe për nëpunësen përgjegjëse. Me vendimin pas zhvillimit të procedurës dhe administrimit të të gjitha akteve si nga dosjet ashtu edhe nga ILD-ja, me vendimin e datës 23.06.2022, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (Komisioni), pasi gjeti të plotë dokumentacionin e dosjes së vlerësimit, vendosi vijimin e procedurës së vlerësimit, me njoftimin e projektraportit të vlerësimit me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, gjyqtares.

Me e- mailin e datës 29.06.2022, gjyqtarja është njoftuar.

Me e-mailin e datës 14.07.2022, gjyqtarja ka konfirmuar se është njohur me projektraportin dhe ka paraqitur kundërshtimet dhe provat përkatëse vetëm për një kriter, kriterin e aftësive organizative, sa i përket treguesit që lidhet me afatin e dorëzimit të dosjeve, për të cilat ju jeni njohur paraprakisht.

Me qëllim vlerësimin e gjyqtares për këtë periudhë janë administruar dy grupe aktesh.

Grupi I: Aktet e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit, konkretisht: Formulari i vetëvlerësimit profesional; Të dhënat e dosjes personale; Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit të administruara në procedurën e rivlerësimit, ku janë të ndarë përkatësisht vitet përkatëse dhe ngarkesa dhe vendimmarrjet e marra nga ana e gjyqtares për tre vitet, nga 2013 dhe deri tek data 08.10.2016, që është periudha e rivlerësimit. Por është sqaruar edhe periudha deri në fund të viti, duke marrë vitin e plotë.

Dosjet e përzgjedhura me short për shkak të rivlerësimit kalimtar (5 dosje) si dhe tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja.

Të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese në periudhën e vlerësimit.

Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me nr. {...} prot., datë 25.03.2016.

Vendimi i kualifikimit të KPK–së.

Grupi i II: Bëjnë pjesë 6 çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit të gjyqtares të cilat janë analizuar nga fq. 17–35 të raporti.

Në pjesën e dytë të raportit është pasqyruar në mënyrë të detajuar analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter (katër kriteret e vlerësimit).

Në mënyrë të përmbledhur po ju pasqyroj konkluzionet e arritura, në kushtet kur ju jeni njohur me projektraportin.

Sa i përket kriterit të "Aftësive profesionale të gjyqtares", konkretisht "Njohuritë ligjore", "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave". Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, por edhe gjatë gjykimit në apel, në ato çështje kur gjykata e apelit e shqyrton çështjen në bazë të juridiksionit fillestar që ajo ka (mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative).

Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e çështjes në vendimet e analizuara, faktet parashtrohen gjithmonë në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, në nën-pjesën e titulluar "Rrethanat e çështjes". Në çdo vendim gjyqësor evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon për cilësimin e saktë të veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi.

Në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën lëndore të gjykatës, konform nenit

54 paragrafi i parë, shkronja “a” të ligjit 49/2012 dhe nenit 467 të K.Pr.C. Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që gjyqtarja e përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dhe herë pas here cituar, në përmbajtjen e vendimit, dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil, të Kodit të Punës dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme, që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Në vendimet burim vlerësimi, krahas dispozitave të Ligjit nr.49/2012, Kodit të Procedurës Civile, Kodit Civil si dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikues dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, dhe konkretisht:

Nenin 118 të Kushtetutës lidhur me parimin e rezervës ligjore dhe të parimit të epërsisë së ligjit.

Nenin 18 të Kushtetutës, si dhe nenin 14 të KEDNJ, në lidhje me parimet e përgjithshme, për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit.

Nenin 44 të Kushtetutës lidhur me të drejtën për t’u rehabilituar për dëmet e pësuara nga veprimet ose mosveprimet e organeve shtetërore.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore me karakter procedural dhe material, për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se aftësia e gjyqtares për paraqitjen dhe analizës e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes

dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar, si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre, ashtu siç ka rezultuar gjatë hetimit në shkallë të parë. Po ashtu rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Për këtë kriter, referuar sa më sipër vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket nëntreguesit “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (kryesisht asaj materiale) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk bëhet pa e shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Tipar karakteristik i gjyqtares është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimin të tyre në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtares sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit.

Gjithashtu konstatohet edhe interpretimi i normave juridike në këndvështrimin sistematik dhe qëllimor të tyre.

Po kaloj tek konkluzioni, meqenëse jeni njohur.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural ashtu edhe në thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtares lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes.

Në lidhje me këtë nënkriter, referuar sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes" është "shumë lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

"Arsyetimi ligjor", "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit". Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit" duhet të vlerësohet "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket "Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit". Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, ku gjyqtarja i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura.

Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të të cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi, si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i gjykatës së shkallës së parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në gjykimin në apel, duke i pasqyruar ato në mënyrë të detajuar kur është rasti.

Pjesa përshkuese–arsyetuese është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht me tituj, si: (i) Rrethanat e çështjes, ku gjyqtarja pasqyron faktet e çështjes, në përputhje me provat e marra gjatë gjykimit në shkallë të parë; (ii) Vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, ku pasqyron në mënyrë të përmbledhur arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me çështjen; (iii) Shkaqet e ngritura në ankim dhe (iv) Vlerësimi i gjykatës, në të cilën gjyqtarja fillimisht citon nenet e ligjit material dhe procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik, merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin abstrakt të tij, para aplikimit mbi faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. Në disa prej vendimeve burim vlerësimi, diktuar nga kompleksiteti i tyre, analiza juridike lidhur me kërkim objekt ankimi, është e strukturuar duke iu referuar me vete secilit kërkim, duke bërë jo vetëm të qartë por edhe të zhvilluar në mënyrë të rrjedhshme në aspektin logjik të argumenteve ligjore.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 50 të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, konform nenit 53 të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore, dhe konform neneve 10/2, b dhe 40/3 të ligjit 49/2012, lidhur me çështjet e shqyrtuar në bazë të juridiksionit fillestar që ajo ka. Gjithashtu, gjen pasqyrim disponimi lidhur me të drejtën e ushtrimit të rekursit, afati i ushtrimit të kësaj të drejte, si dhe data e shpalljes së vendimit.

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e mirë strukturuar, gjithmonë sipas këtij rendi; parashtrimi i rrethanave të çështjes, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, vlerësimin e gjykatës administrative të apelit, duke filluar fillimisht me trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, lidhur me pranueshmërinë e ankimit, ligjin e zbatueshëm, trajtimin e çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Kështu, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Për sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin "Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit" duhet të vlerësohet "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

"Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtares në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe evidentohet interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve të cilat janë objekt ankimi apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Për këtë tregues, vlerësohet që shkalla e aftësisë së gjyqtares duhet të vlerësohet "shumë e lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.

Kështu, propozimi për sa i përket kriterit “Aftësia profesionale e gjyqtares” propozohet "Shkëlqyeshëm", duke u pikëzuar me 100 pikë.

Për sa i përket “Aftësisë organizative të gjyqtares”, “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, konkretisht në treguesin “Respektimi i afateve ligjore”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja dhe 1 (një) vendim të administruar për shkak të ankesave.

Në nenin 48 pika 2, të Ligjit nr. 49/2012, përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjet brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi, që do të thotë nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë.

Gjithashtu, në nenin 10 pika 2, germa b), përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj. Në ligjin nr.49/2012 nuk janë përcaktuar afate për gjykimin e padive në shkallë të parë nga gjykata administrative e apelit. Por vetë ligji i posaçëm mund të parashikojë afate për gjykimin e këtyre padive në shkallë të parë nga Gjykata Administrative e Apelit.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 1 (një) vendim të administruar për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve rezulton se në 12 (dymbëdhjetë) prej tyre parashikohen afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes, pasi një çështje është shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykata, konkretisht vendimi nr.14, datë 29.09.2014 dhe për dy çështje të tjera, shqyrtimi i tyre ka kaluar në seancë gjyqësore, pra jo në Dhomë Këshillimi siç shqyrtohen zakonisht çështjet në gjykimin në apel.

Për 12 (dymbëdhjetë) çështjet për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, sikundër referohet më sipër, 10 (dhjetë) prej tyre kanë përfunduar në tejkalim të afatit ligjor, pra gjyqtarja rezulton të ketë gjykuar 83.34% të çështjeve jashtë afatit ligjor. Referuar tabelës së pikëzimit për këtë tregues, të përcaktuar në rregulloren nr.264/2019, kjo përqindje ekuivalentohen me 3 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën objekt vlerësimi (04.11.2013 – tetor 2016) të vlerësimit 1407 çështje, nga të cilat 907 çështje administrative dhe 500 marrëdhënie pune dhe rreth 1584 çështje deri në përfundim të vitit 2016, duke e marrë të plotë afatin 3-vjeçar të vlerësimit, pra mesatarisht 528 çështje në vit, pa përfshirë këtu ngarkesën si anëtare e trupit gjykues. Në lidhje me aspektin e rritjes së papritur të volumit të punës, rezulton se gjatë vitit 2014 volumi i punës në Gjykatën Administrative të Apelit është rritur ndjeshëm si pasojë e vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku rezulton se gjatë vitit 2014 gjyqtares i janë caktuar 1669 çështje, pra mesatarisht rreth 151 çështje në muaj (pa përfshirë këtu muajin gusht kur gjyqtarët kryejnë lejen e zakonshme) dhe janë shqyrtuar prej saj 625 çështje, mesatarisht 56,81 çështje në muaj (pa përfshirë muajin gusht të pushimeve verore). Pra ajo ka dhënë rreth 2.7 vendime në ditë, referuar ditëve mesatare të punës në muaj prej 21 ditë. Gjithashtu, rezulton se në vitin 2015, gjyqtares i janë caktuar 1259 çështje të reja dhe ka përfunduar gjykimin për 492 çështje administrative dhe marrëdhënie pune dhe gjatë vitit 2016 i janë caktuar 1352 çështje administrative dhe ka përfunduar gjykimin për 466 çështje.

Po kështu, në lidhje me aspektin e kushteve të punës, rezulton se për periudhën 04.11.2013 – 09.06.2015 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ishin pjesë e organikës së saj ndihmësit ligjorë, sikurse parashikohej në nenin 6 të ligjit 49/2012, çka do të ndikonte ndjeshëm në lehtësimin e ngarkesës së punës, duke iu referuar këtu edhe detyrave të parashikuar në këtë nen lidhur me ndihmësit ligjor. Sipas shkresave të ndodhura në dosjen e vlerësimit, rezulton se së paku deri në muajin dhjetor 2015, ende pranë kësaj gjykate nuk ishin caktuar ndihmësit ligjorë. Gjithashtu ka rezultuar se numri i stafit mbështetës, konkretisht i sekretareve në dispozicion të gjyqtarëve ka qenë i vogël, fillimisht një sekretare për tre gjyqtarë dhe më pas një sekretare për dy gjyqtarë, të cilat fillimisht nuk kanë qenë të kualifikuara për natyrën e punës që do të kryenin. Gjithashtu, rezultoi se gjykata ka filluar funksionin e saj efektivisht në datë 04.11.2013, si një gjykatë e re e caktuar me ligj, me kompetenca e afate të reja ligjore.

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 83.34 % (ii) ngarkesën e gjyqtares si relatore (në total ka gjykuar 1584 çështje), duke gjykuar mesatarisht rreth 528 çështje në vit (iii) rritja e papritur të volumit të punës dhe (iv) aspektet që lidhen me kushtet e punës, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja duhet të vlerësohet “0–10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimit të standardeve minimale”. Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 1 (një) vendim i administruar për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve rezulton se vetëm për 3 (tre) prej tyre nuk parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, konkretisht 1 çështje që i përket vendimit nr. 14, datë 29.09.2014, është shqyrtuar nga kjo gjykatë, në bazë të kompetencës funksionale të saj,

duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë, dhe dy çështje, shqyrtimi i të cilave ka kaluar në seancë gjyqësore.

Kemi arritur në një konkluzion që për të vlerësuar në standardin minimal, pavarësisht se të gjithë gjykimet në Gjykatën Administrative parashikojnë afat ligjor, në momentin kur çështja ka kaluar në seancë gjyqësore, ne kemi marrë për ta vlerësuar nga momenti i caktimit të seancës gjyqësore deri në momentin e dhënies së vendimit pa vlerësuar kohën të cilën nuk është vënë në lëvizje nga gjyqtarja dhe pa e vlerësuar si afat ligjor këtë çështje.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit në gjykatën e shkallës së parë dhe as për shqyrtimin e tyre nga gjykata e apelit si shkallë e parë dhe as për çështje, shqyrtimi i të cilave kalon në seancë gjyqësore. Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, ai parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Ndërkohë, në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, nuk rezulton të jetë përcaktuar standardi minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e apelit, por rezulton që për gjykatat e apeli të jetë përcaktuar standardi minimal kohor vetëm për gjykimet civile, duke u përcaktuar ky afat, jo më tej se 6 muaj, afat që llogaritet nga dita që gjykata ka vendosur nxjerrjen e çështjes për shqyrtim. Kështu, për analogji, pasur parasysh faktin se jemi përpara gjykimit në apel me natyrë administrative do t'i referohemi standardit minimal të përcaktuar për gjykimet civile në apel, jo më tej se 6 muaj të përcaktuar në pikën 5, germa (h) të vendimit nr.261/1 datë 14.04.2010 të KLD.

Nëse do t'i referoheshim këtij standardi të përcaktuar për gjykimet civile në gjykatat e apelit, atëherë do të rezultonte se për 3 çështjet që nuk është përcaktuar afat ligjor gjykimi, nga dita që gjyqtarja ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë gjyqësore kanë përfunduar brenda një afati mesatar prej 3 muaj e 13 ditë, pra brenda

afatit 6-mujor të standardit minimal kohor të përcaktuar për gjykimet civile në gjykatën e apelit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të tria çështjet.

Për sa më sipër, lidhur me këtë tregues, vlerësoj se në kushtet kur standardi minimal kohor është zbatuar për të tria çështjet e analizuar, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Sa i përket "Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje". Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar vetëm tre çështjet për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimi, konkretisht; dy vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe vendimin e përzgjedhur me short gjatë procedurës së vlerësimit kalimtar, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor.

Konkretisht, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për këto 3 (tre) çështje, një çështje në kategorinë e çështjeve "Çështje të juridiksionit fillestar", rezulton të jetë 129 ditë, rreth 4 muaj e 9 ditë, dhe për 2 çështje të kategorisë "administrative themeli", të shqyrtuara në seancë gjyqësore, rezulton të jetë 3 muaj e 3 ditë, pra rreth 94 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për çështjen e analizuar, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Në këto kushte, për këtë tregues propozohet vlerësimi i gjyqtares me 5 pikë.

Për sa i përket "Rendimentit të përfundimit të çështjes". Për të gjithë periudhën e vlerësimit rezulton se gjyqtares i janë caktuar në total 4280 çështje dhe ka përfunduar me vendim deri në dhjetor 2016, 1584 çështje. Sa i përket rendimentit sipas këtyre të

dhënave, rezulton një normë likuidimi çështjesh prej 37%, aq sa ka rezultuar edhe nga raporti për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ-ja.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: "Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli."

Lidhur me përcaktimin e aspektit sasior në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, nuk rezulton të jetë përcaktuar një standard orientues në aspektin sasior për gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në apel, por vetëm për gjyqtarin e shkallës së parë të dhomës civile, që gjykon në seksionin administrativ. Kështu, për analogji, pasur parasysh faktin se jemi përpara gjykimit në apel me natyrë administrative do t'i referohemi standardit sasior të punës së përcaktuar për gjyqtarin e dhomës civile. Sipas pikës 3 shkronja "i", të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile.

Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja për periudhën e vlerësimit, konkretisht deri në fund të muajit dhjetor 2016 ka përfunduar rreth 1584 çështje, pra ka përfunduar dukshëm më shumë se standardi minimal i ngarkesës i përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit dhoma civile (164 % më shumë, rreth 528 çështje në vit, nga 200 të përcaktuara për gjyqtarin e gjykatës së apelit).

Në lidhje me aspektin rritjes së papritur të volumit të çështjeve, rezulton se gjatë vitit 2014 gjyqtares i janë caktuar 1669 çështje; në vitin 2015 i janë caktuar 1259 çështje dhe në vitin 2016 i janë caktuar 1352 çështje, fakt ky që ndikon në llogaritjen

matematikore të normës së likuidimit të çështjes. Gjithashtu u arsyetuan edhe kushtet e punës.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit është 37 %, i përcaktuar dhe në Raportin KLGJ-së, përqindje e cila referuar Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 2 pikë, duke marrë në analizë të dhënat e tjera që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të cituara më sipër, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht, me 10 pikë.

Për këtë arsye është propozuar për treguesin "Rendi i përfundimit të çështjeve" pikëzimi i saj me 10 pikë.

"Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve përfundimtare". Në nenin 55, pika 3 të Ligjit 49/2012, parashikohet se: "Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore". Nuk po i citoj të gjitha burimet e vlerësimit, të cilat janë pasqyruar hollësishëm në raportin e vlerësimit.

Gjithashtu, përveç dosjeve të cilat janë hedhur me short dhe të përzgjedhura nga gjyqtarja, në dosjen e rivlerësimit ka pasur edhe një relacion të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të datës 19.11.2014, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimeve nga gjyqtarja {...}, ku ka rezultuar se për 81 vendime, nuk është respektuar afati ligjor prej 7 ditësh, për dorëzimin e dosjes gjyqësore pas dhënies së vendimit përfundimtar.

Po kështu, në relacionin e datës 06.11.2014, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimit nr.{...}, datë 15.07.2014, të dorëzuara nga gjyqtarja jashtë afatit ligjor prej 7 ditësh, konkretisht dorëzuar në datën 05.09.2014, pas 52 ditësh.

Lidhur me shkaqet e mosarsyetimit të vendimeve brenda afatit ligjor, referuar relacionit, rezulton se gjyqtarja ka parashtruar si shkak për dorëzimin me vonesë të vendimeve të arsyetuara, ngarkesën e punës, jo vetëm për shqyrtimin e çështjeve të caktuara me short, por edhe të atyre çështjeve në të cilat gjyqtarja ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Po kështu, vonesa në dorëzimin e dosjeve ka ardhur jo vetëm për shkak të ngarkesës së dosjeve në gjykim, por edhe për shkak të mungesës së

infrastrukturës, në drejtim të mungesës së sekretares gjyqësore, në drejtim të mungesës së printerit, letrës, bojë printeri, kompjuterit etj. Një tjetër shkak i parashtruar nga gjyqtarja ka qenë edhe mungesa e ndihmësit ligjor. Në fakt këto shkaqe janë parashtruar përsëri nga ana e gjyqtares në kundërshtimet e saj, me të cilat ju jeni njohur, ku ka referuar edhe analizat e bëra nga KLD-ja e mëparshme.

Referuar të dhënave burim vlerësimi, konkretisht vetëm 11 dosjeve të shortuara për të cilat ka të dhënë lidhur me afatin e dorëzimit të dosjes, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7-ditor të parashikuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

- Në çështjet e kategorisë "Administrative me palë kundërshtare", koha mesatare e arsyetimit është 19.3 ditë;

- Në çështjet e kategorisë "Marrëdhënie pune", koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 6.6 ditë.

- Ndërsa po t'i referohemi të gjitha akteve të tjera të përcjellë edhe me informacionin e lartpërmendura rezulton se në çështjet e kategorisë "Administrative me palë kundërshtare", koha mesatare e arsyetimit është 41 ditë;

Pra, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e gjatë se afati 7-ditor i përcaktuar në nenin 55, të Ligjit nr.49/2012, për gjysmën e kategorive të çështjeve, duke përkuar me një vlerësim prej 9 pikësh, referuar tabelës së përcaktuar në rregulloren me nr.264/2019.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë trevjeçare, konkretisht ka dhënë 1584 vendime themeli, mesatarisht rreth 2.3 vendime në ditë.

Për këtë tregues është propozuar që gjyqtarja të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi, kjo duke pasur parasysh se vlerësuesi nuk mund të vlerësojë aftësinë e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues tej rritjes së pikëzimit me vetëm 1 shkallë. Sa më sipër, për këtë tregues "Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar" të konsiderohet "Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve", duke e pikëzuar nga 9 në 12 pikë.

Sa i përket "Numrit mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale". Referuar sa më sipër, për treguesin "Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive", duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 4 seanca, por rezulton që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri i seancave gjyqësore është më i madh se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive është e lartë, prandaj vlerësoj se gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë për këtë tregues.

Për sa i përket treguesit "Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor", referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efiçencës së treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Përgjithësisht, rezulton se shkak për fillimin me vonesë të seancave gjyqësore është bërë zgjatja e gjykimeve të mëparshme. Nga ana tjetër, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel administrativ, në dhomë këshillimi, apo në seancë gjyqësore.

Referuar sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë për këtë tregues duhet të vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit në dosje”, aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda të njëjtës kategori. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Sa i përket nëntreguesit “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë në këtë tregues. Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet, procesverbalet e çdo seance për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi apo për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (parashtrimet, prapësimet e palëve).

Sa më sipër, për treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” propozohet të vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Për kriterin “Aftësia organizative e gjyqtares” propozohet vlerësimi i saj "Shkëlqyeshëm" me 97 pikë.

Për sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, konkretisht “Etika në punë”. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton të ketë sjellje që mund të cenojë etikën në punë. Për këto

arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe duhet të pikëzohet me 35 pikë.

"Integriteti i gjyqtares", "Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti". Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren janë paraqitur gjithsej 12 (dymbëdhjetë) ankesa, në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat vetëm 4 (katër) prej tyre janë verifikuar dhe regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik, ankesat e tjera janë arkivuar për shkak se janë pretendime që mund të zgjidhen përmes apelimit të vendimit apo me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me këtë tregues, për sa i përket kriterit pasuror, është arritur në përfundimin, pas analizimit të provave të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, duke e parë çështjen nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit dhe duke e vlerësuar në tërësinë e saj kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi – pamjaftueshmëria financiare e lartpërmendur, sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklarimet vjetore, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit.

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me aspektin e figurës ka arritur në konkluzionin: "Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, indiciet dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, nuk u gjetën elementë të mjaftueshëm që të përbënin shkak për shkarkim".

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

Për këtë tregues, gjyqtarja duhet të vlerësohet për aftësi "shumë të larta", duke e pikëzuar me 40 pikë.

Për sa i përket treguesit “Paanësia”, “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtim”. Referuar të dhënave të administruara nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqjen dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard të cilat janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (KLD-së dhe KLGJ-së) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, konkretisht referuar shkresës nr. {...} prot., datë 01.08.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, rezulton se për periudhën e vlerësimit 2013-2016 janë paraqitur 10 (dhjetë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat 2 (dy) prej tyre janë pranuar. Evidentohet se në çështjen për të cilën është pranuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, me vendimin nr. 47, datë 01.12.2014, gjyqtarja ka paraqitur dy herë kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, kërkesa këto të cilat janë refuzuar nga kryetari i gjykatës.

Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se për periudhën e vlerësimit 2013-2016, vetëm dy kërkesa janë pranuar për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi, dhe në një nga këto kërkesa evidentohet se gjyqtarja ka paraqitur më parë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi.

Për sa më sipër, për këtë tregues propozohet vlerësimi i saj me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe i pikëzimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozohet vlerësimi i saj "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë.

Në këtë rast dua të evidentoj faktin se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 21.09.2022, pra pas marrjes së vendimit për mbylljen e procedurës së vlerësimit të

gjyqtares, është paraqitur shkresë me anë të cilës është njoftuar vendimi i fillimit të hetimit disiplinor me nr.{...} prot., datë 21.09.2022, me anë të cilit ka filluar hetimi disiplinor për gjyqtarët, ndër të cilët është edhe znj. {...}. Kjo çështje është filluar mbi bazën e ankimit të z. {...}, e protokolluar me nr.{...} prot., datë 15.12.2016, i cili ka ngritur pretendime në lidhje me një vendim gjyqësor.

Në datë 14.10.2022, pranë Këshillit është protokolluar shkresa me nr.{...} prot, me anë të cilit është përcjellë vendimi nr.{...} prot., datë 14.10.2022 e ILD, "Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}", me arsyetimin se nuk provohet kryerja e shkeljes disiplinore. Nga të dhënat e këtij vendimi nuk referohet ndonjë rast që mund të vlerësohet për sa i përket etikës profesionale të gjyqtares.

Sa i përket kriterit "Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional", konkretisht "Aftësia e komunikimit". Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Sa më sipër, për këtë tregues vlerësohet aftësia e gjyqtares "shumë e lartë", duke e pikëzuar me 25 pikë.

"Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale". Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Për këtë tregues, duhet të vlerësohet niveli i gjyqtares "i lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

"Aftësia për të bashkëpunuar". Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta. Për këtë arsye, propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Shkalla e bashkëpunimit dhe komunikimit me administratën gjyqësore”. Edhe për këtë tregues ka mungesë të dhënash për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit. Për këtë arsye prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta dhe propozohet pikëzimi i saj me 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”. Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit si dhe vërtetimit me nr. {...} prot., datë 18.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtarja {...} ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertes, lehtësueses dhe pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

(i) Në cilësinë e ekspertes në 3 (tre) aktivitete, gjithsej 6 ditë trajnimi;

(ii) Në cilësinë e lehtësueses në 2 (dy) aktivitete, gjithsej 3 ditë trajnimi;

(iii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në 11 (dymbëdhjetë) aktivitete trajnuese, gjithsej 18 ditë trajnimi.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 16 aktivitete dhe rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë edhe në aktivitete jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat rezultojnë të jenë aktivitete të formimit profesional, si dhe aktiviteteve ndërinstitucionale të tilla si trajnime online. Konkretisht ka marrë pjesë në trajnimin “online” të organizuar nga Këshilli i Evropës, organizata HELP në periudhën 24.04.2013 - 24.11.2013, certifikuar në datë 31.12.2013, (ii) ka marrë pjesë ne trajnimin 1 (një) ditor organizuar nga Departamenti i Drejtësisë së SHBA-së me mbështetjen e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Tiranë me temë “Etika e gjyqtarëve”, (iii) trajnim i organizuar MATRA PATROL me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme e Holandës në Hagë, me temë “Akses në drejtësi”.

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës administrative, gjithsej 16 aktivitete të zhvilluara për 39 ditë,

kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare.

Për këtë arsye vlerësohet që gjyqtarja duhet të pikëzohet me 20 pikë.

Për sa i përket "Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve", referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertes në 3 (tre) aktivitete trajnuese dhe në cilësinë e lehtësuese në 2 (dy) aktivitete.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Për sa i përket "Angazhimit të gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun", referuar të dhënave ka rezultuar angazhimi i gjyqtares si eksperte në punën e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efiçencës. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka deklaruar se ka marrë pjesë në trajnime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës:

(i) Referuese lidhur me organizimin e drejtësisë administrative në Shqipëri, në konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Beograd, Serbi, në datat 9–10 qershor 2016 me temë "Kuadri ligjor administrativ në Ballkanin Perëndimor", organizuar nga RESPA;

(ii) Referuese lidhur me organizimin e drejtësisë administrative në Shqipëri, në konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Podgoricë, Mal i zi, në datat 22–23 nëntor 2016 me temë "Kuadri ligjor administrativ në Ballkanin Perëndimor", organizuar nga RESPA.

Referuar sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë, për sa kohë që rezultuan të dhëna të angazhimit të saj.

Për sa i përket treguesit "Publikimet ligjore", rezulton se gjyqtarja ka publikime ligjore, konkretisht:

Shkrimi me titull "Kompetenca e gjykatave administrative" botuar në revistën "Jeta Juridike" nr.3, e Shkollës së Magjistraturës, shtator 2015, me numër identifikimi ISBN.

Për sa më sipër, duke iu referuar metodologjisë, vlerësoj se për gjyqtaren ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Kështu niveli i vlerësimit dhe i pikëzimit për kriterin "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional" propozohet 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit: Aftësitë profesionale të gjyqtares propozohet 100 pikë, "Shkëlqyeshëm"; Aftësitë organizative të gjyqtares, 97 pikë, "Shkëlqyeshëm"; Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm"; Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm". Në total, propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është "Shkëlqyeshëm" me 397 pikë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, fjalën ia jap magjistrates znj. {...}, për të parashtruar shkurtimisht kundërshtimet, nëse keni gjëra të tjera përveç atyre që keni depozituar me shkrim dhe që anëtarët e Këshillit i kanë në dispozicion dhe janë njohur me to.

{...}: Faleminderit!

E nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit!

Së pari dua t'ju falënderoj për dhënien e mundësisë për të qenë në këtë seancë dëgjimore dhe për t'u shpjeguar lidhur me projektvlerësimet që trajtohen sot në këtë mbledhje plenare.

E kam vlerësuar të nevojshme jo vetëm në respekt të punës suaj si Këshill, për të gjithë treguesit e marrë në analizë dhe të reflektuara në relatimin e gjyqtares Plaku, të bëj një shpjegim mbase të nevojshëm për specifikën e gjykimit administrativ në Gjykatën Administrative të Apelit, si gjykatë e posaçme. Mbase do të ishte e nevojshme, nuk e di, do ta vlerësoni ju mbase, që unë pasi të dëgjoj edhe relatimin e zonjës Yllka për relatimin e dytë, të japë..., sepse janë të lidhura çështjet.

Naureda Llagami: E di që janë të lidhura, por procedura është që do mbarojmë me raportin, bëhet vlerësimi i raportit të parë. Më pas, do relatohet raporti i dytë; do jepni parashtresat; dhe do të bëhet vlerësimi i raportit të dytë.

{...}: Si ta vlerësoni ju.

Naureda Llagami: Nëse ju vlerësoni që doni t'i thoni që tani për efiçencë kohe.

{...}: Janë të lidhura në fakt çështjet e ngritura. Është në vlerësimin tuaj.

Atëherë, unë duhet të shpjegohem për projektin e parë.

Naureda Llagami: Fokusohuni vetëm tek projekti i parë.

{...}: Nuk po ndalem, sepse parashtrimet ju i keni.

E kam vlerësuar maksimalisht sigurisht punën e grupit të punës dhe të relatorit në të gjithë treguesit e prezantuar.

Në fakt, historiku i krijimit të Gjykatës Administrative të Apelit është specifik. Është gjykatë që ka funksionuar me një ligj të posaçëm dhe ka filluar së funksionuari në 4 nëntor 2013. Unë jam gjyqtare. Unë jam gjyqtare në këtë gjykatë që prej krijimit të saj dhe duke njohur natyrën e punës në këtë gjykatë, duke u përballur me një numër shumë të lartë çështjesh gjyqësore. Jam këtu përpara jush për të shpjeguar pikërisht ngarkesën e lartë të çështjeve me të cilat është përballur kjo gjykatë që në nisje, që në nisje të punës së saj, ngarkesë me të cilën në fakt sot po përballen gjykatat e juridiksioneve të të gjitha niveleve, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Por Gjykata e Apelit Administrativ, këtë situatë e ka pasur që në nisje të punës së saj dhe arsyeja lidhet me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, që sigurisht ju jeni në dijeni, statistikat janë, treguesit janë. Për t'u evidentuar për shembull është që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, për shkak të vendimit unifikues, u regjistruan për gjykim 6.585 çështje. Ndërsa në fund të vitit 2014 që përkon me vitin e parë të punës, kanë qenë të regjistruara për gjykim 18.921 çështje, pra mesatarisht për çdo gjyqtar të Gjykatës Administrative të Apelit ka pasur një ngarkesë mesatare çështjesh 2.703 (që në nisje të punës).

Problematikat u evidentuan. Ka qenë një gjykatë me një organikë të reduktuar. Që në nisje falë një konkurrimi, për ta thënë këtë, sepse Gjykata Administrative e Apelit u krijua me procedurë konkurrimi të gjyqtarëve në nivelin e njohurive profesionale. Dekreti i Presidentit të Republikës që normoi mënyrën e organizimit të kësaj gjykate, diktoi numrin 7 të gjyqtarëve, pra 7 gjyqtarë që mbulonin ngarkesën me çështjet e evaduara nga gjashtë apelet e Republikës së Shqipërisë; me një infrastrukturë të cunguar le të themi sepse mungonte asistenca e ndihmësve ligjorë, rekrutimi i të cilëve u bë i mundur vetëm në qershor të vitit 2015; me një infrastrukturë burimesh njerëzore me probleme. Mund të themi që edhe ajo që u prezantua në raport është që një sekretare gjyqësore asistonte punën e tre gjyqtarëve; të patrajnuar në mënyrën sesi do azhurnoheshin me parashikimet e ligjit të ri për gjykatat administrative. Të gjitha këto diktuan një ngarkesë të jashtëzakonshme që në nisje të punës.

U relatua në projekt ngarkesa ime me çështje por sigurisht edhe vendimet e marra. Janë numër shumë i madh besoj. Dhe po të shikoni edhe statistikat e viteve në vijim,

unë jam nga gjyqtaret që kam gjykuar numrin më të lartë të çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, duke mos neglizhuar dhe pjesëmarrjen dhe aktivizimin në trajnime, duke qenë pjesëmarrëse vazhdimisht në trajnime por edhe me avancimin pastaj edhe në pjesën modeste, kontributin modest që unë kam dhënë në dhënien e praktikës gjyqësore atje ku jam e ftuar për shkak të angazhimeve, edhe në konferenca ndërkombëtare rajonale për gjykimin administrativ, një risi në juridiksionin e gjykatave shqiptare. E kam vlerësuar maksimalisht mënyrën se si është hartuar projektvlerësimi sepse për mua ka shumë rëndësi analiza e cilësisë së vendimmarrjes së gjykatës. Janë evidentuar çështjet që ngriti relatorja. Unë kam evokuar në këtë analizë të vendimeve vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në disa raste, duke qenë se kemi qasje drejt direktivave të Bashkimit Evropian janë sjellë edhe raste të Gjykatës së Luksemburgut, sidomos për çështjet e tatimeve dhe të doganave. Duke pasur parasysh edhe natyrën e posaçme që ka gjykimi administrativ, që unë mbase do t'i them në një analizë më të detajuar në dëgjimin e raportit të dytë, do doja të kihen në vëmendje të Këshillit pikërisht koha sepse e thashë jam realisht e vlerësuar në mënyrën se si është bërë projekti, por mendoj që vlerësimi i gjyqtarit, performanca e gjyqtarit duhet parë në raport me të gjithë situatën specifike që ka pasur në gjykim.

Çështjet jashtë afatit 7-ditor të arsyetimit. Në fakt afati 7-ditor është një afat krejt minimal në raport me ngarkesën që ka gjyqtari administrativ në punë, në raport me natyrën e çështjeve që gjykon, aktet nënligjore normative, një fushë e gjerë në të gjithë spektrin e sektorit publik ku do duhet të bëhen hulumtime në legjislacion, duhet kohë për vendimmarrje. Do doja nga ana juaj ta rivlerësoni edhe një herë mbase pikëzimin për kohën e arsyeshme për dorëzimin e vendimeve gjyqësore në afat.

Në fakt çështjet lidhen pikërisht (e kam evidentuar në parashtresë) që lidhen me periudhën korrik – gusht 2014, kohë në të cilën administrata gjyqësore dhe trupa gjyqësore janë planifikuar me lejen e përvitshme vjetore.

Lidhur me relatimin, sepse u relatua në fakt që ka pasur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mbase për ta përmendur shkurt, ajo ka qenë një çështje "pension ushtaraku" që lidhej pikërisht me mënyrën se si duhet të trajtoheshin mosmarrëveshjet lidhur me

këtë kategori çështjesh. Në kohën kur ne kemi gjykuar çështjen, kishim praktika të ndryshme gjyqësore nga të gjitha gjykatat e niveleve të shkallës së parë dhe të apelit dhe pasi ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Apelit, në dhjetor të vitit 2016, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, morën një vendim unifikues për mënyrën se si do të trajtohen çështjet e pensionit të parakohshëm për vjetërsi në shërbimin për ushtarakët dhe ka qenë kjo arsyeja që ky procedim i nisur/i arkivuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë është marrë në analizë më vonë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe është mbyllur pa veprime hetimore, për shkak se ka qenë pikërisht nevoja e unifikimit të këtyre praktikave, që ka çuar në një vendimmarrje të caktuar.

Në mënyrë të përgjithshme këto kisha.

Në mënyrë më të detajuar do të ndalem mbase në raportin e dytë.

Naureda Llagami: Pra gjë konkrete për këtë raportin ishte vetëm për pjesën e afateve.

{...}: Po, afatet.

Naureda Llagami: Faleminderit!

A kemi ndonjë pyetje, përpara se të largohet gjyqtarja.

(Nuk ka pyetje nga anëtarët.)

Ok! Faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)

Naureda Llagami: Nga ana e relatores lidhur me kundërshtimet që parashtroi magjistratja.

Irena Plaku: Atëherë, magjistratja parashtroi kundërshtimet për sa i përket afatit të dorëzimit të vendimeve, të cilat janë marrë në konsideratë. Gjithashtu ka paraqitur

edhe disa prova për sa i përket datës së dorëzimit apo datës së nënshkrimit të vendimeve. Nga ato që kanë rezultuar nga burimet e vlerësimit, ato data 1-2 ditë janë marrë parasysh dhe nuk janë konsideruar për t'u konsideruar jashtë afatit.

Është vlerësuar në atë nivel pikësh duke marrë parasysh edhe ngarkesën dhe të gjitha ato që ka konstatuar dhe referoi në fakt gjyqtarja, të cilat janë referuar edhe tek një raport i mëparshëm të KLD-së, që ka bërë një vlerësim të situatës së gjykatës administrative, dhe për këtë arsye është rritur edhe me një nivel sipas rregullores e cila përcakton rritjen me një nivel vlerësimi në rastin kur vendimet janë jashtë afatit ligjor. Nga 9 është rritur me një nivel, duke e çuar në 12, referuar asaj që përcakton rregullorja. Kështu që, unë vlerësoj që nuk ka prova të reja të cilat janë paraqitur nga gjyqtarja dhe të cilat të çojnë në një vlerësim të ndryshëm. Unë si relatore e kam të pamundur, duke qenë se rregullorja parashikon rritjen vetëm në një nivel. Kështu që i qëndroj propozimit për vlerësimin dhe pikëzimin e gjyqtares edhe për këtë tregues.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nga kolegët?

Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Atëherë, duke dëgjuar edhe gjyqtaren, duke dëgjuar edhe raportin, vlerësoj se duhet të sillet në vëmendje edhe një fakt tjetër. Gjatë vitit 2013–2016, për gjyqtarët e gjykatës së apelit administrativ janë zhvilluar disa herë inspektime për vonesa në dorëzimin e dosjeve ose të vendimeve të arsyetuara. Në materialin dhe në raportin që na është përcjellë, ka dy referime nga ish–Inspektorati pranë KLD–së (bëhet fjalë për materialin 2, materialin 3, faqe 12 dhe 13 të projektraportit të vlerësimit), ku evidentohen se nuk janë vetëm disa vendime nga 11 dosje, të dhëna në periudhën korrik – gusht, por në fakt janë rreth 51 vendime (janë 81, por 30 të dorëzuara brenda afatit dhe 51 të tejkaluara në materialin nr. 3 dhe 1 vendim tjetër që i përket materialit nr. 2). Në të dyja këto raste, inspektori, pasi ka analizuar ngarkesën e punës së gjyqtares, angazhimin e saj dhe sigurisht vlen të theksoj që një numër i tillë kaq i lartë vendimesh gjyqësore,

sigurisht që është një rrethanë që Këshilli duhet ta ketë parasysh. Por nga ana tjetër, a mund të shkojmë në një pikëzim maksimal? Jo vetëm për shkak të metodologjisë por edhe për shkakun tjetër që pavarësisht se kjo ngarkesë pune e ka bërë të pamundur (sipas gjyqtares) dorëzimin e vendimit brenda 7 ditëve. Referuar raporteve të ILD-së këto janë dy situata që ne na janë referuar që duhet t'i marrim parasysh në vlerësimin etik dhe profesional, pra është konkluduar që nuk përbëjnë shkak për fillim procedimi disiplinor, por që duhet të llogariten kur bëhet fjalë për standardin sasior, pra kur bëhet fjalë për kohën mesatare të dorëzimit të vendimit të arsyetuar. Nga ana tjetër, edhe nëse nuk do të respektohet afati 7 ditë, por do të marrim në analizë afatin 20-ditor që sot parashikohet për gjykatat e apelit (se ndoshta edhe 7 ditë me atë volum çështjesh dhe me atë volum vendimesh është e pamundur për ta respektuar), por edhe 20 ditë përsëri është në tejkalim të afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar. Penalizimi me ulje me 3 pikë nuk duhet të vlerësohet nga ana e gjyqtares sikur është penalizim i punës së gjyqtares, sepse në fakt ne ketë standard kemi ndjekur tek të gjitha rastet e tjera. Ka pasur raste që gjyqtarët nuk kanë pasur të dhëna statistikore për 3 vite në rastet e gradimit dhe i ka penalizuar vetëm një çështje e cila ka qenë e dorëzuar për 40 apo për 60 ditë. Prandaj edhe për të respektuar këtë mënyrë trajtimi të gjyqtarëve të tjerë gjatë gradimit, unë vlerësoj që nuk është rasti për të bërë një pikëzim në nivelin maksimal, sepse është rritur një nivel për shkak të kushteve të punës dhe për shkak të një volumi pothuajse të paimagjinueshëm që mund të përballohet nga ana e gjyqtarit në këtë periudhë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë propozim?

Atëherë, në kushtet që nuk ka një propozim, kalojmë në votim projektraportin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord. *(Vota e zonjës Luli nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, e vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit. "Kam votuar dakord". E-maili me konfirmimin e votës së saj i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.12.2022)

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për vitin 2021, relatore znj. Yllka Rupa (Shtyrë nga mbledhja plenare e datës 02.11.2022).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:23 dhe mbaroi në orën 15:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

10. Brikena Ukperaj ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Genta.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

8. {...}, magjistrate.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për vitin 2021, relatore znj. Yllka Rupa (Shtyrë nga mbledhja plenare e datës 02.11.2022).

Naureda Llagami: Kalojmë tek shqyrtimi i raportit të dytë.

Të ftohet sërish gjyqtarja.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, në vijim të procedurës, gjyqtarja është prezente.

Ia jap fjalën zonjës Yllka Rupa që është relatorja e projektraportit për vlerësimin etik dhe profesional për gjyqtaren, për vitin 2021.

Yllka Rupa: Faleminderit Kryetare!

E nderuar gjyqtare {...}!

Në cilësinë e relatores unë do të prezantoj projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional që ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtares në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për të katër kriteret mbi bazën e të cilit vlerësohet veprimtaria e gjyqtares. Njëkohësisht do të prezantoj vlerësimin e përgjithshëm përpara mbledhjes plenare, e cila do të marrë vendim në lidhje me propozimin tim.

Gjyqtarja {...} ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për në Gjykatën e Lartë dhe për këtë qëllim, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.118, datë 29.03.2022, ka filluar procedura e përshpejtuar e detyruar për vlerësimin etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: Relatore unë, Yllka Rupa; Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj.Gilda Hoxha.

Kjo procedurë vlerësimi ka vijuar konform parashikimeve ligjore. Gjyqtarja është njoftuar për fillimin e procedurës së vlerësimit, për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të çdo anëtari të Këshillit. Gjyqtarja ka konfirmuar marrjen e njoftimit, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit, si dhe nuk ka kërkesë për përjashtimin e tyre ose të ndonjë anëtari të Këshillit.

Në vijimësi gjyqtares {...} dhe zëvendëskryetares së Gjykatës Administrative të Apelit, i është dërguar njoftimi për plotësimin e "Formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit". Formulari i integruar, së bashku me dy vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja janë protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor më datë 14.06.2022.

Po kështu, me shkresa të ndryshme i është kërkuar informacion Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares {...} gjatë periudhës së vlerësimit dhe Shkollës së Magjistraturës për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e saj në veprimtaritë trajnuese.

Pjesë e dosjes së vlerësimit është bërë edhe kopja e aktit përfundimtar të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, të dërguar nga institucioni përkatës.

Pas evidentimit të çështjeve me palë kundërshtare të përfunduara nga gjyqtarja përtej afateve ligjore dhe standard minimal kohor, në datën 05.04.2022, është disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares për periudhën e vlerësimit janar–dhjetor 2021, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të shortit. Urdhri i është njoftuar gjyqtares, zëvendëskryetares dhe kancelarit të gjykatës përkatëse.

Në datën 08.04.2022, në Gjykatën Administrative të Apelit, është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim, dokumentuar në procesverbalin përkatës.

Pas administrimit të 6 (gjashtë) dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, ka filluar nga nëpunësi përgjegjës për vlerësim, hartimi i raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares për vitin 2021.

Me vendimin e datës 12.07.2022 Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vendosur plotësimin e dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura në krijimin e dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së raportit analitik për gjyqtaren {...}, periudha përkatëse e vlerësimit, si dhe vijimin e procedurës së vlerësimit me hartimin e projektraportit të vlerësimit.

Projektraporti i është njoftuar gjyqtares {...} në adresën e saj elektronike në datën 26.09.2022 dhe brenda afatit njëjavor, në datën 03.10.2022 gjyqtarja depozitoi kundërshtime lidhur me projektraportin e vlerësimit. Konkretisht gjyqtarja paraqiti kundërshtime lidhur me kriterin e “Aftësive organizative”, duke kundërshtuar të pestë treguesit që lidhen me aftësitë e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

Në mbështetje të pretendimeve të paraqitura gjyqtarja paraqiti si prova:

(i) Kalendarin i gjykimeve për vitin 2021;

(ii) Vendime për ndarjen e trupave gjykues;

(iii) Urdhrin e vendimeve për rishortimin me short të çështjeve gjyqësore;

(iv) Analizën vjetore të Gjykatës Administrative të Apelit për vitin 2021;

(v) Materialet për temat "Tatimi mbi vlerën e shtuar në fokusin acquis communautaire dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për T.v.sh", "Pavlefshmëria absolute dhe paligjshmëria e aktit administrativë në zbatim të dispozitave të Kodit të Ri të Procedurave Administrative dhe ligjit nr.49/2012, i ndryshuar", të përgatitura në kudër të sesionit trajnues në Shkollën e Magjistraturës;

(vi) Materialet me temë "Taksimi i dyfishtë në dogana", "Veçoritë e gjykimit në apelin administrativ", "Kontrolli mbi pushtetin diskrecial të organeve publike", përgatitur për studentët e Shkollës së Magjistraturës;

(vii) Certifikatë mbi pjesëmarrjen në seminarin e organizuar nga EIPA;

(viii) Vërtetimet të Shkollës së Magjistraturës mbi rolin e gjyqtares {...} në cilësinë e ekspertes pedagoges së jashtme në Shkollën e Magjistraturës.

Gjithashtu, në datat 05.10.2022 dhe 10.10.2022 gjyqtarja ka paraqitur dokumentacion dhe sqarime plotësuese në lidhje me projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën janar – dhjetor 2021, konkretisht:

(ix) Kopje të Revistës Juridike Shkencore të Shkollës së Magjistraturës, nr.2, viti 2021, ku është botuar artikulli "Pushteti diskrecional i organeve publike dhe kontrolli ndaj tij" ku rezulton që gjyqtarja të jetë bashkautore;

(x) Ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit, për vitet 2017, 2019;

(xi) Ngarkesën e gjykimeve gjatë viteve 2013 deri në shtator 2021;

(xii) Urdhër "Për miratimin e lejeve dhe gatishmërisë për gjyqtarët" me nr.273 Prot., data 21.07.2021;

(xiii) Libër dorëzim dosjesh për vitin 2021;

(xiv) Libër dorëzim dosjesh për vitin 2014.

Kundërshtimet ju janë vënë në dispozicion në momentin kur janë paraqitur nga gjyqtarja.

Në projektraportin e vlerësimit është pasqyruar analiza e plotë e të dhënave të nxjerra nga burimet e vlerësimit. Në cilësinë e relatores unë do të referoj lidhur me

konkluzionet e arritura për secilin kriter, nivelin e pikëzimit si dhe nivelin e vlerësimit. Gjithashtu, do të paraqes edhe vlerësimin që është mbajtur në lidhje me analizën e plotë të kundërshtimeve të paraqitura nga gjyqtarja dhe provave përkatëse.

Kriteri "Aftësia profesionale e gjyqtares", është kriteri i parë mbi të cilën përgatitet raporti dhe vlerësohet nëpërmjet njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.

Për të pikëzuar aftësitë e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit, bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale të cilat përcakton vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Njohuritë ligjore vlerësohen në komponentin "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave". Si burime vlerësimi për të pikëzuar këtë tregues kanë shërbyer dokumentacionet ligjorë të dorëzuara nga gjyqtarja, formulari i vetëvlerësimit dhe aktet e dosjeve të përzgjedhura me short.

Nga analiza e të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit konstatohet aftësi shumë e lartë e gjyqtares në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, përcaktimin e natyrës së çështjes, duke saktësuar natyrën e marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, gjithashtu edhe në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm. Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme, gjyqtarja identifikon dhe referon më së miri edhe ligjit të zbatueshëm një sërë dispozitash kushtetuese dhe akte ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimit të normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe për këtë arsye në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet maksimalisht për aftësi shumë të larta dhe të pikëzohet me 25 pikë.

Për të kaluar tek komponenti tjetër "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes". Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë

tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtares lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e gjyqtares në treguesin "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes" duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me "Arsyetimin ligjor", "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit." Në tërësi, referuar të dhënave, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Referuar këtij konkluzioni, propozoj që në lidhje me këtë komponent të vlerësohet për aftësi shumë të lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket "Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit gjyqësor", edhe në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtjen të tij. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtares në këtë tregues, duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik. Në tërësi, referuar të dhënave edhe për këtë komponent, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë. Gjyqtarja analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjes, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së saj, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi

logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre në rastin në shqyrtim. Gjyqtarja e zhvillon argumentimin e saj duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t'i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur kështu standardin e një procesit të rregullt ligjor. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues, duhet të vlerësohet shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 25 pikë.

Pra propozimi për kriterin e parë të vlerësimit "Aftësitë profesionale të gjyqtares" është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për të kaluar tek kriteri "Aftësitë organizative të gjyqtares".

Gjyqtarja ka kundërshtuar rezultatin e vlerësimit dhe pikëzimit për pesë komponentët, mbi bazën e të cilëve vlerësohet aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë dhe konkretisht kundërshtohet pikëzimi dhe niveli i vlerësimit për treguesin "Respektimi i afateve ligjore", "Plotësimi i standardeve minimale kohore", "Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje", "Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore", si dhe "Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor". Për pjesën tjetër nuk ka kundërshtime, pasi vlerësimi ka qenë maksimal.

Kundërshtimet gjyqtarja i ka mbështetur në provat që u cituan më lart.

Vlerësuesi ka detyrimin ligjor për të kryer vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit sipas kritereve të vlerësimit të matura nga treguesit përbërës që janë përcaktuar në metodologjinë e pikëzimit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Si burim vlerësimi për këtë tregues kanë shërbyer të dhënat statistikore, vlerësimi i kryer nga vetë gjyqtarja dhe konform nenit 86 të ligjit "Për statusin" gjyqtari bën vetëvlerësimin e aftësive organizative, duke përzgjedhur shkallën e aftësisë për çdo tregues vlerësimi mbi bazën e një analize të pavarur të të dhënave statistikore, referuar tabelave statistikore që janë vënë në dispozicion. Gjithashtu edhe mendimi i kryetarit të gjykatës i cili vlerëson aftësitë e gjyqtarit duke u mbështetur në të dhënat statistikore gjithashtu.

Në lidhje me "Aftësinë e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë", "Respektimi i afateve ligjore".

Në nenin 48 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, parashikohet se: "...Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi…". Në nenin 51 të po këtij ligji, parashikohet se: "Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar situata që ka përcaktuar dispozita përkatëse (vijon dispozita me përcaktime të tjera) Në referim të dispozitave të mësipërme, çështje që janë shqyrtuar në dhomë këshillimi, do të llogariten me afat 30-ditor, në kuptim të nenit 48 të ligjit, ndërsa çështjet të cilat janë shqyrtuar në seancë gjyqësore, në mungesë të një afati të posaçëm, do të llogariten me afat standard minimal, duke iu referuar afatit standard minimal për shqyrtimin e çështjeve në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, afat i parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2 datë 14.04.2010 të ish-KLD, në të cilën përcaktohet se: "Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë:... c) Gjykimet civile në gjykatën e apelit, jo më tej se 6 muaj".

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar 78 çështje jashtë afatit ligjor, nga 80 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, ose e thënë në përqindje gjyqtarja 97% e çështjeve me afat ligjor, janë gjykuar në tejkalim të këtij afati. Duke i ndarë sipas kategorive, çështjet e gjykuara tej afatit ligjor, rezultojnë si më poshtë:

(i) 57 çështje të kategorisë "Çështje me palë kundërshtare" të shqyrtuar në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Koha e gjykimit të tyre varion nga 36 ditë deri në 3 vjet e 9 muaj, me një mesatare vonese prej 360 ditë nga afati 30-ditor i parashikuar në ligjin përkatës.

(ii) 8 çështje nga kategoria "Çështje pa palë kundërshtare", me objekt "Sigurim padi", "Pezullim akti apo pezullim veprimesh përmbarimore" dhe "Shkelje afati gjykimi", kanë përfunduar jashtë afatit ligjor, të parashikuar nga neni 28 i ligjit

49/2012 i ndryshuar dhe neni 399/7 i K.Pr.Civile (lidhur me kërkesat me objekt shkelje afati gjykimi). Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 5, 7 dhe 9 kanë përfunduar për 6 ditë, duke e tejkaluar afatin ligjor vetëm me 1 ditë, tejkalim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përllogaritjen e afatit. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 5 çështje. Koha e gjykimit të tyre varion nga 10 ditë deri në 211 ditë, me një mesatare vonese prej 94 ditë, nga afati 5 ditor i parashikuar në nenin 28 të ligjit 49/2012 dhe nga afati 45-ditor i parashikuar nga nenin 399/7 i K.Pr.Civile.

(iii) 13 çështje të kategorisë "Marrëdhënie pune", të shqyrtuara në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 8 dhe 9 kanë përfunduar për 36 ditë, duke e tejkaluar afatin ligjor vetëm me 6 ditë, tejkalim ky që konsiderohet i papërfillshëm, duke pasur parasysh këtu edhe ngarkesën e gjykatës, si dhe organizmin e saj në trupa gjyqësore. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit 11 çështje. Koha e gjykimit të tyre varion nga 145 ditë deri në 2 vjet e 11 muaj, me një mesatare vonese prej 307 ditë nga afati 30-ditor i parashikuar në ligjin 49/2012.

Duke përjashtuar çështjet e analizuara si më sipër, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (73 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (80 çështje), rezulton të jetë 91% të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, e cila sipas Metodologjisë kjo përqindje pikëzohet me 3 pikë.

Analiza e të dhënave statistikore nuk është bërë nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e mbështetur në të dhënat burimore. Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit në projektraportin e vlerësimit, nga ana ime në cilësinë e relatores është konsideruar (i) ngarkesa e gjyqtares si relatore dhe anëtare, ku në total ka gjykuar 154 çështje si relatore dhe 296 çështje si anëtare; (ii) mendimi i zv/kryetares dhe vetëvlerësimi i gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen

e gjykimit; (iii) numri i lartë i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtarja ka qenë relatore pasi rezulton të ketë përfunduar 80 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë 52% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në vitin 2021; (iv) si dhe duke pasur në vëmendje se caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankimin e palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit, është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet dy nivele më lartë se pikëzimi që i përket përqindjes prej 91% të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit dhe që në rastin konkret përkon me pikëzimin prej 9 pikësh. Kjo duke pasur në konsideratë pranimin e proporcionalitetin dhe objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja në kundërshtimet e saj ka kërkuar pikëzimin maksimal me 15 pikë, duke parashtruar disa rrethana objektive të pavarura prej saj, që kanë ndikuar në kriterin e aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë. Argumentet e parashtruara nga gjyqtarja afektojnë të gjithë treguesit e kriterit "Aftësisë organizative" për pjesën e aftësive të gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë dhe për këtë arsye do të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në këtë pjesë, për të mos u përsëritur në treguesi e tjerë në vijim. Gjyqtarja parashtron si vijon:

Në lidhje me historikun e Gjykatës Administrative të Apelit: Numër i lartë çështjesh gjyqësore në raport me numrin e ulët të gjyqtarëve duke u ndaluar në (i) përballimin i një ngarkese të lartë çështjesh ndër vite me një organikë të përbërë vetëm prej 7 gjyqtarësh, duke mos pasur një raport të drejtë midis treguesve për numrin e gjyqtarëve dhe volumit të ngarkesës midis gjykatave administrative dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, (ii) shtim i parapritur i numrit të çështjeve si rezultat i vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 6.12.2013, edhe në vitet në vijim me efekt zinxhir nga vitet paraardhëse, me gjithë ngarkesën e evaduar të çështjeve duke pasur një numër shumë të lartë çështjesh në raport me numrin e pamjaftueshëm të gjyqtarëve në organikën e saj, në vitin 2020 kanë ushtruar detyrën 9 gjyqtarë nga 13 që parashikohet në organikë; (iii) Të dhënave statistikore për vitin

2021, referuar Analizës Vjetore të Gjykatës Administrative të Apelit për vitin 2021, ku rezulton se ngarkesa me çështje gjyqësore është shumë e lartë në raport me numrin e trupës gjykuese prej 5 gjyqtarësh. Monitorimi i afateve kohore nuk duhet të kufizohet në mbledhjen e të dhënave në lidhje me afatet kohore totale ndërmjet fillimit dhe përfundimit të proceseve gjyqësore, por duhet të vlerësohet gjithashtu informacion mbi kohëzgjatjen e fazave të ndërmjetme të procesit dhe shkaqeve objektive që mund ta kenë cenuar këtë proces.

Gjithashtu gjyqtarja ka parashtruar ndikimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve pra si një shkak objektiv që ka ndikuar në performacën e saj në aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, në shtimin e papritur të ngarkesës me çështje gjyqësore dhe përballimin e ngarkesës në punë, duke pasqyruar ndikimin e këtij procesi gjatë vitit 2021, përgjatë të cilit janë shkarkuar edhe katër gjyqtarë të kësaj gjykate. Gjyqtarja paraqet në mënyrë të detajuar kronologjinë e shkarkimit të gjyqtarëve si dhe procedurën e rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të shkarkuar mes të gjithë anëtarëve të trupës gjyqësore të mbetur. Në këto kushte, në këtë situatë jo të zakontë pune, planifikimi i seancave gjyqësore dhe i dhomave të këshillimit në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk ishte më përgjegjësi e ekskluzive e gjyqtarit relator, por ajo ishte e lidhur ngushtësisht me mundësinë e anëtarëve të tjerë të trupës gjyqësore për t'u angazhuar në planifikimet e pritshme dhe për pjesëmarrjen në proceset e gjykimit.

Ndikimi i Pandemisë Covid-19;

Aplikim i gabuar i metodologjisë sipas vendimit të KLD nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve", duke argumentuar se ky akt nënligjor i hartuar në vitin 2010 nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk duhet të gjejë zbatim në vlerësimin e gjyqtares, për shkak se ky akt është hartuar në një kohë kur gjykatat administrative ende nuk ishte krijuar. Ky akt i përgjigjet një situate tjetër në sistemin gjyqësor kur numri i gjyqtarëve dhe ngarkesa e çështjeve për gjykim ishte normale. Në këtë situatë minimalisht, meqë ligji nr.49/2012 nuk parashikon afate për përfundimin e gjykimit si shkallë e parë, referenca ligjore duhet të jetë afati 1-vjeçar i parashikuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile.

Po kështu, në sqarimet plotësuese të depozituara në datën 10.10.2022 gjyqtarja parashtron:

Kundërshtimet në lidhje me 6 (gjashtë) çështjes gjyqësore të përzgjedhura me short, duke u ndaluar në ecurinë procedurale të tyre, si dhe duke saktësuar datën e dorëzimit të këtyre vendimeve;

Gjithashtu edhe disa aspekte të procedurës specifike të gjykimit në apelit administrativ me ndikim në kohëzgjatjen e gjykimeve konkrete, duke u ndaluar tek shtyrja e dhomës së këshillimit për shkak të plotësimit të të metave të ankimit dhe njoftimin e ankimit të plotësuar palëve të tjera ndërgjyqëse sipas praktikës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Latë, çështjet me kalim procedural në dhomë këshillimi sipas praktikës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, çështjet që gjykohen si gjykatë e shkallës së parë.

Gjyqtarja ka kërkuar që këto rrethana të merren në konsideratë në vlerësimin në drejtim të aftësive për të përballuar ngarkesën në punë në vitin 2021, për të shmangur përfundime që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Argumentet e parashtruara nga gjyqtarja lidhur me ngarkesën e lartë të çështjeve ndër vite, që prej vitit 2013 e në vijim, apo shtim i parapritur i numrit të çështjeve si rezultat i vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, janë marrë parasysh dhe janë vlerësuar nga Këshilli në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares për periudhën 2013-2016, pasi vendimi unifikues nuk sjell rritje të papritur të volumit të punës, gjatë vitit 2014, dhe nuk vlerësoj se ky vendim ndikon në vlerësimin e vitit 2021. Lidhur me argumentet për ngarkesën e lartë të punës gjatë vitit 2021, apo edhe ndikimi i procesit të rivlerësimit kalimtar, të dyja këto aspekte janë marrë në konsideratë në projektraportin e vlerësimit, dhe prandaj është propozuar pikëzimi dy nivele më lart se ai që i përket përqindjes së pikëzimit. Ndërsa në lidhje me ndikimin e Pandemisë Covid-19 apo aplikimi i gabuar i metodologjisë së vlerësimit sipas vendimit të KLD nr.261/2, datë 14.04.2010, janë argumentet të cilat janë marrë në konsideratë në treguesit e tjerë sepse afektojnë treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore”. Nga analiza e të dhënave statistikore nuk rezulton në asnjë rast që tejkalimi i afateve ligjore të ketë ardhur si

pasojë e ndikimit të pandemisë, pasi tejkalimi i afateve ligjore shkon në disa raste deri në 3 vite.

Lidhur me pretendimin e gjyqtares se tejkalimi i afatit 7-ditor për kryerjen e veprimeve përgatitore në çështjen administrative me nr.44, datë 16.06.2021 ka ardhur si pasoje e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë, evidentohet se kjo çështje është çështje e juridiksionit fillestar, dhe si e tillë është konsideruar çështje me standard minimal kohor, dhe nuk ndikon në treguesin e "Respektimi i afateve ligjore". Shkak i tejkalimit të afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 25 të ligjit 49/2012, i ndryshuar, afekton në treguesin "Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor", tregues ky i vlerësuar në nivelin maksimal.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit, që gjyqtarja të rritet me dy nivele, standard që është ndjekur nga Komisioni në të gjitha rastet që është aplikuar në situata të ngjashme kur gjyqtari ka pasur rendiment pune shumë më të lartë. Në këto kushte, në lidhje me treguesin "Respektimi i afateve ligjore", gjyqtarja vlerësoj se duhet të vlerësohet në nivelin "21-30%", duke u pikëzuar ky nivel me 9 pikë.

Për të kaluar tek komponenti tjetër, "Plotësimi i standardeve minimale kohore". Ky tregues nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve orientuese të përcaktuara nga KLG-ja për këtë kategori çështjesh.

Sikurse u analizua edhe më mësipërm, çështjet gjyqësore të shqyrtuara në seancë gjyqësore do të konsiderohen si çështje me standard minimal kohor. Po kështu, edhe çështjet e juridiksionit fillestar, do të konsiderohen çështje me standard minimal kohor, në kushtet kur këto çështje gjykohen në bazë të kompetencës funksionale të gjykatës, duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë dhe në ligjin nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative" nuk parashikohen afate ligjore për gjykimin e çështjeve të themelit në shkallë të parë.

Plotësimi i standardeve minimale kohore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve orientuese, për çdo kategori çështjesh, të përcaktuar në vendimin

përkatëse që është ende në fuqi. Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 ku përcaktohen kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore, nuk rezulton të jetë përcaktuar standardi minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e apelit, por rezulton që për gjykatat e apeli të jetë përcaktuar standardi minimal kohor vetëm për gjykimet civile, duke u përcaktuar ky afat, jo më tej se 6 muaj.

Lidhur me zbatimin e këtij vendimi, gjyqtarja ka parashtruar se aplikimi i këtij akti nënligjor, është i gabuar dhe nuk duhet të gjejë zbatim në vlerësim, për shkak se ky akt është hartuar në një kohë kur gjykatat administrative ende nuk ishin krijuar, por për sa kohë që ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimit si shkallë e parë, referenca ligjore duhet të jetë afati 1-vjeçar i parashikuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile.

Është e vërtetë që vendimi nr.261/2, datë 14.04.2010 nuk parashikon afate orientuese për gjykimin e çështjeve administrative për gjykatën e apelit, por ky vendim parashikon afate orientuese për gjykimin e çështjeve administrative në shkallë të parë dhe pikërisht në pikën 5, shkronja "c" parashikohet se "Gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e shkallës së parë, duhet të jenë jo me tej se 1 muaj". Rezulton pra se ky akt e ka të qartë natyrën e shpejt të gjykimit administrativ dhe rëndësinë e tij gjithashtu. Në kushtet e mungesës së një përcaktimi për apelin administrativ, KLGJ-ja ka vlerësuar që standardi kohor i punës së gjyqtarit të gjykatës së apelit administrativ të matet në referencë me standardin e përcaktuar për gjykimet civile në gjykatën e apelit për të cilat parashikohet një gjykim jo më tej se 6 muaj. Duke ditur natyrën specifike të gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Administrativ, mendoj që kjo mënyrë e matjes së punës së gjyqtarit në raport me aspektin e rendimentit në kohë është shumë favorizuese për gjyqtarin.

Pavarësisht këtij parashikimi, në projektraportin e vlerësimit referimi lidhur me standardet minimale kohore është bërë sipas pikës 5, shkronja "h", kjo duke pasur parasysh specifiken e gjykimeve administrative në gjykatën e apelit, po kështu edhe

duke pasur parasysh qëndrimin e Këshillit në vlerësimet e mëparshme, për të gjithë gjyqtarët, përfshitë këtu edhe gjyqtaren {...} e cila u vlerësua për periudhën 2013-2016, po mbi bazën e këtij akti dhe për këtë periudhë nuk rezulton të ketë paraqitur kundërshtim.

Lidhur me pretendimin për aplikimin si referencë ligjore të nenit 399/2, pika 1, shkronja "a" i K.Pr.Civile, vlerësoj se kjo reference ligjore nuk mund të aplikohet si afat orientues, sikurse përcaktohet në metodologjinë e pikëzimit, por ka lidhje me afatin e arsyeshëm për përfundimin e gjykimit dhe me të drejtën që pala ka për t'ju drejtuar gjykatës me kërkesë për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të "Konventës Evropiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".

Pranimi i afatit 6-mujor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Administrativ, për të cilat nuk parashikohen afate ligjore është pranuar nga KLGJ-ja si një kriter matës për të vlerësuar të gjithë gjyqtarët. KLGJ gjithashtu ka pranuar zbatimin e këtij afati orientues, në respektim për aq sa është e mundur të parimeve të gjykimit administrativ, duke ditur natyrën e gjykimit administrativ, detyrimin për të siguruar gjykimin e çështjeve brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme dhe për të përmbushur në këtë mënyrë edhe qëllimin e vetë gjykimit administrativ. Pra nuk mund të operohet me afate gjykimi që cenojnë të drejtën e qytetarit për një gjykim të shpejtë dhe efiçent në kohë.

Afati i përfundimit të gjykimit për Gjykatën Administrative të Apelit, për çështjet për të cilat nuk ka afat ligjor gjykimi, është konsideruar periudha kohore nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim nga gjyqtari relator deri në datën e shpalljes së vendimit, në referim kjo të Udhëzuesit "Për plotësimin e tabelave me të dhënat statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve", miratuar me vendimin nr.60, datë 30.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin

Analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:

(i) 13 çështje tek tabela nr.1, kategoria "Çështje me palë kundërshtare", dhe konkretisht çështjet me numër 5, 12, 13, 19, 20, 23, 24, 28, 32, 33, 41, 42 dhe 87 rendor, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6-mujor të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

(ii) 2 çështje tek tabela nr.3, kategoria "Marrëdhënie pune", dhe konkretisht çështjet me nr.1 dhe 15 rendor kanë përfunduar jashtë afatit 6-mujor të parashikuar po në këtë vendim, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështja me numër rendor 15, ka përfunduar për 6 muaj e 3 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë standardin minimal kohor, tejkalim ky që konsiderohet i papërfillshëm. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 1 çështje. Koha e gjykimit të cilës është 1 vit 3 muaj e 2 ditë.

(iii) 4 çështje tek tabela nr.4, kategoria e çështjeve "Juridiksion fillestar", dhe konkretisht çështjet me nr. 1, 4, 8 dhe 15 rendor kanë përfunduar jashtë afatit 6-mujor të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështja me numër rendor 1 ka përfunduar për 6 muaj e 18 ditë, nëse në afatin e gjykimit nuk do të përfshihej periudha e lejes vjetore (muaj gusht), atëherë çështja do të kishe përfunduar brenda afatit 6-mujor. Sa më sipër, për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit 3 çështje.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (17 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (74 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar rreth 22.9 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

Në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja për këtë tregues të vlerësohet një nivel me lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, kjo duke pasur në

konsideratë faktin se në afatin e gjykimit të disa çështjeve (konkretisht në 7) ka ndikuar edhe periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar (janë disa vendime të KLGJ-së që kanë pezulluar veprimtarinë gjyqësore).

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar për vitin 2021, në total 154 çështje, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 200 çështje në vit, ngarkesë pune që nuk justifikon pikëzimin maksimal të gjyqtares për këtë tregues.

Për të kaluar tek nënkriteri tjetër që është "Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje".

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar për gjysmën e kategorive të çështjeve.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve, specifikat e gjykimit në apelin administrativ në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre dhe pesë gjyqtarë, si dhe faktin se gjyqtarja ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, duke e vlerësuar me 4 pikë, por jo në nivelin maksimal, në kushtet kur numri i çështjeve të përfunduar gjatë vitit 2021, nuk justifikon vlerësimin maksimal të gjyqtares për këtë tregues.

"Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore". Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara si relatore (154), me numrin e çështjeve të caktuara brenda këtij viti kalendarik (790) është 19.49%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 2 pikë.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore është një rezultat konkret faktik i punës së gjyqtarit. Metodologjia e vlerësimit jep një rëndësi të veçantë vlerësimit të këtij treguesi duke përcaktuar në mënyrë strikte pikëzimin në situata ku mund të ketë arsye të motivuara për të rritur nivelin e vlerësimit të gjyqtarit. Si burim vlerësimi për këtë tregues, Metodologjia ka parashikuar ndër të tjera, edhe vlerësimin e kryer nga gjyqtari. Gjyqtari në vlerësimin që bën ka listuar shkaqet, rrethanat që kanë ndikuar në performancën e saj, në aspektin e rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore, ndërsa ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë, si në rastin kur standardi tejkalohet me mbi 99% të çështjeve të gjykuara, ku në fakt rendimenti i përfundimit të çështjeve është vetëm 19,94 %. Raporti i vetëvlerësimit pra është një burim që duhet të përmbajë të dhëna reale që lidhen me veprimtarinë e gjyqtarit dhe padyshim të paraqesë edhe rrethanat që kushtëzojnë paraqitjen më të mirë të gjyqtarit në ushtrim të funksionit, rrethana të cilat detyrimisht duhet të analizohen nga vlerësuesi dhe vlerësohen sipas përcaktimit që jep Metodologjia e Vlerësimit.

Edhe nga ana e kryetarit të gjykatës është mbajtur po i njëjti qëndrim në mendimin e shprehur lidhur me aftësitë e gjyqtares për këtë tregues.

Referuar metodologjisë, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik mbi 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit, dhoma civile.

Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtarja të ketë gjykuar më shumë se standardi minimal i punës, pasi gjyqtarja gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 154 çështje si relatore (nga të cilat 122 çështje janë me palë kundërshtare), nga 200 çështje të përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit dhoma civile, por nga ana tjetër duke pasur parasysh edhe ngarkesën e saj si anëtare (ka përfunduar 296 çështje në këtë cilësi) në

projektraport është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet dy nivele më lart se ajo që i përket përqindjes së pikëzimit, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtares lidhen edhe me organizmin e gjykatës në trupa gjyqësore me tre dhe pesë gjyqtarë apo edhe problematikave të lindura për shkak të largimit të gjyqtarëve për shkak të procesit të vetingut. Pra, gjyqtarja është propozuar të rritet me dy nivele, dhe do të vlerësohet në nivelin "Mbi 87-93%", përqindje e cila pikëzohet me 6 pikë.

Për të kaluar tek "Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor". Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7-ditor të parashikuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20% ose jo më shumë se një shkallë më lart pikëzimi.

Bazuar në këtë parashikim, në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja, lidhur me këtë tregues, të pikëzohet një shkallë më lartë se ajo që i përket përqindjes së pikëzimit, pra duke u pikëzuar me 6 pikë, duke konsideruar si faktor që ka ndikuar në këtë tregues, kompleksitetin e çështjeve, si dhe volumin e çështjeve.

Referuar akteve të depozituara prej gjyqtares (kopje e regjistrit të dorëzimit të vendimeve) evidentohet se data e vendimit të arsyetuar nuk përputhet me datën e pasqyruar në të dhënat statistikore, duke pasqyruar në to datën e dorëzimit të vendimit në sekretari nga nëpunësi përkatës.

Edhe pas analizës së të dhënave të depozituar nga gjyqtarja rezultoi se:

Në kategorinë "Çështje me palë kundërshtare" koha mesatare e arsyetimit është rreth 17 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

Në kategorinë “Çështje pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 19 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është rreth 15 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

Në kategorinë e çështjeve “Juridiksion fillestar” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është rreth 21 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

Për sa më sipër, edhe me këto të dhëna, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, rezulton më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe që përkon me 3 pikë sipas metodologjisë.

Në projektraportin e vlerësimit duke konsideruar si faktor që ka ndikuar në këtë tregues, kompleksitetin e çështjeve, si dhe volumin e çështjeve, është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi dhe konkretisht me 6 pikë, kjo duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20% ose e thënë ndryshe jo më shumë se një shkallë më lart se niveli i pikëzimit, siç përcakton Metodologjia e Vlerësimit.

Në lidhje me nënkriterin tjetër “Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore”, “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive” dhe “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se nuk ka të dhëna për numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, pasi te numri i seancave janë pasqyruar edhe seancat përgatitore në çështjet e kategorisë “Juridiksion fillestar”, pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues vlerësohet mbi bazën e çështjeve të shortuara të përzgjedhura me short.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore referuar 3 (tre) nga 6 (gjashtë) çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, janë shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja është 5.3 seanca gjyqësore.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, duke iu referuar akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet procedurën e kryerjes së njoftimeve, duke verifikuar se njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, si dhe njoftimin e të drejtës së palëve për të paraqitur deri në 5 ditë para seancës parashtrimet me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundër ankimin;

Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe të ndryshme. Konkretisht, evidentohet se tre seanca nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues, për shkak të pamundësisë shëndetësore të relatores ose shkarkimin e dy anëtarëve të trupit gjykues në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: lënia kohë për plotësimin e të metave të padisë apo kthimi i padisë me të meta, komunikimi për palët jo prezente të kërkesës për thirrjen në proces të personit të tretë, komunikimi i akteve palëve, njoftimin e palës paditëse pas vendimmarrjes së gjykatës për kalimin procedural për shkak të ligjit, njoftimin e ekspertit apo për shkak të dhënies kohë palës së paditur, e të tjera aspekte procedurale si këto.

Në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla (afati 5-ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar apo për shpalljen e arsyetuar të vendimit).

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga

vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 5.3 seanca, por rezulton që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave me efektivitet. Pavarësisht se numri i seancave gjyqësore është më i madh se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive është e lartë, prandaj në projektraport kam propozuar që gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

"Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor", edhe në këtë aspekt gjyqtarja ka cilësi të veçanta dhe për këtë arsye propozohet që ky tregues të vlerësohet "shumë i lartë" dhe të pikëzohet me 20 pikë.

"Aftësitë e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore", në tre komponentët: "Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes" është pikëzuar me 5 pikë, gjithashtu edhe "Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes" vlerësohet shumë e lartë, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin "Aftësitë organizative të gjyqtares" është 79 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Në lidhje me "Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale" është kriteri i tretë mbi bazën e të cilit vlerësohet gjyqtari. "Etika në punë", "Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion". Duke u mbështetur në burimet e vlerësimit për këtë tregues...

Naureda Llagami: Yllka, ndjesë! A mund të bëjmë përmbledhje për efekt të kohës, për t'i dhënë mundësi pastaj edhe gjyqtares.

Yllka Rupa: "Etika në punë". Në lidhje me këtë tregues gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë angazhimi dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion, dhe propozohet pikëzimi me 35 pikë.

Në lidhje me "Integritetin", në të gjithë komponentët, "Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti", 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtares” e cila vlerësohet për sa i përket “Përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese”, “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve”, në të dy komponentët vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet përkatësisht 10 dhe 15 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për këtë kriter është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Gjithashtu edhe në kuadër të “Aftësive personale dhe angazhimit profesional”, “Aftësia e komunikimit” – 25 pikë, vlerësohet “shumë e lartë”.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe privatësisë” – 15 pikë, vlerësohet “shumë e lartë”.

“Aftësia për të bashkëpunuar” – 15 pikë, vlerësohet “shumë e lartë”.

“Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore” gjithashtu “shumë e lartë”, 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”. Në këtë aspekt ka cilësi të spikatura gjyqtarja, dhe propozohet të vlerësohet me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”. Në këtë pikë gjyqtarja është vlerësuar 5 pikë për shkak të aspekteve të trajnimeve që ka paraqitur.

“Publikimet ligjore dhe akademike”. Në këtë pjesë gjyqtarja ka paraqitur kundërshti sepse nuk ka paraqitur një publikim në revistë shkencore dhe është marrë në konsideratë publikimi që ju keni paraqitur tek Revista Shkencore e botuar nga Shkolla e Magjistraturës. Vlerësohet me 5 pikë.

Pra propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional është 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është dhe nivel i përgjithshëm i vlerësimit është ky:

Aftësitë profesionale të gjyqtares, 100 pikë, niveli "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative të gjyqtares, 79 pikë, niveli "Shumë mirë".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në total, propozoj për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit 379 pikë, “Shumë mirë”.

Ky është edhe propozimi i Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në lidhje me gjyqtaren {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Rupa për relatimin e projektraportit.

Atëherë, për ju fjala zonja {...}.

Ju lutem shkurtimisht, duke marrë parasysh që ne, të gjithë kundërshtimet tuaja i kemi të administruara. Të ndaleni vetëm në pikat kryesore ku ju mendoni që vlerësimi nuk është në proporcion me atë që ju kërkoni.

{...}: Faleminderit zonja Kryetare!

Faleminderit relatores për relatimin!

Unë i kam përgatitur me shkrim. Sigurisht do fokusohem pa u ndalur gjatë në ato kundërshtime. Por meqenëse nuk e dëgjova në relatimin që bëri zonja relatore të gjithë parashtresën e natyrës të posaçme që ka gjykimi administrativ në Gjykatën Administrative të Apelit, e vlerësoj të nevojshme që ta bëj një prezantim përpara Këshillit, shkurtimisht sigurisht.

Ju keni përpara sot të nderuar anëtarë të Këshillit një gjyqtare të Gjykatës Administrative të Apelit. Në dijeninë time, është e para herë që po vlerësohet një gjyqtar i kësaj gjykate. Do doja të fokusohesha pikërisht në natyrën e posaçme që ka gjykimi në këtë gjykatë. Me krijimin e gjykatave administrative, gjyqësia administrative tashmë funksionon sipas një ligji të posaçëm, që është ligjit “Për gjykatat administrative”.

Një veçori e gjykimit në këtë gjykatë është gjykimi i akteve nënligjore normative. Për shkak të ometimit ligjor që kishte përpara se të hynte në fuqi ky ligj, ishin jashtë kontrollit të ligjshmërisë. Pra nëse për kushtetutshmëri këto akte shqyrtoheshin në

Gjykatën Kushtetuese, ligjvënësi e pa të nevojshme që t'ia nënshtronte gjykimin një gjykate të posaçme dhe për shkak të rëndësisë, këto çështje gjykohen me 5 gjyqtarë. Bëhet fjalë për vendime të Këshillit të Ministrave, për urdhra, urdhëresa, udhëzime të autoriteteve qendrore të administratës publike; bëhet fjalë për vendime të Këshillit Bashkiak që miratojnë taksa, tarifa vendore, që miratojnë kundërvajtje administrative në territorin juridiksional të një bashkie të caktuar; akte rregullatore me natyrë të përgjithshme për institucionet e administratës publike. Pra janë çështje që kërkojnë një kohë të posaçme gjykimi, kanë një peshë specifike gjykimi. Nëse në gjykimin kushtetues këto çështje mund të parashtrohen për kushtetutshmëri duke prekur dispozita të caktuara të Kushtetutës, që sigurisht janë të kufizuara dhe parimet kushtetuese, mund të ndodhë, siç ka ndodhur në Gjykatën Administrative të Apelit, në gjykimin abstrakt që bën kjo gjykatë për kontrollin e ligjshmërisë së normës, të pretendohet papajtueshmëria me disa ligje, pra kundërshtimi bëhet në një aspekt shumë të gjerë, që kërkon një analizë shumë të posaçme, shumë të cilësuar. Rastësisht, në gjashtë vendime gjyqësore që janë përzgjedhur për efekt të trajtimit tim profesional, është një akt nënligjor normativ, është Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve (po e citoj rastin), kundër një urdhërese të Ministres së Drejtësisë, në lidhje me zhvillimin e disa procedurave për efekt të trajtimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë. Sigurisht, e para, afati 7-ditor që parashikon ligji i posaçëm "Për gjykatën administrative" për dorëzimin e vendimit brenda këtij afati, dukshëm në raport edhe me afatin që ka Gjykata Kushtetuese kur shqyrton kushtetutshmërinë e një akti nënligjor, është shumë i shkurtër. Plus në rastin konkret, meqenëse e lidhëm, ka pasur edhe vendim pakice, ka pasur edhe vendim kundër, kohë e cila i përkon pikërisht kohës që ka marrë gjyqtari anëtar për të relatuar dhe për të bërë pakicën. Gjykimi i këtyre akteve me 5 gjyqtarë kërkon kohë për diskutim, kërkon kohë për vendimmarrje, kërkon kohë për seancat gjyqësore, sigurisht kërkon kohën e duhur për efekt të arsyetimit të vendimit gjyqësor për shkak të rëndësisë që ka (pra efektin erga omnes) në shumë raste në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Prandaj ju solla në vëmendje pikërisht këtë karakterin që ka Gjykata Administrative e Apelit në raport me juridiksionin kushtetues.

Një veçori tjetër që ka Gjykata Administrative e Apelit është se është gjykatë që ndodhet midis dy juridiksionesh, pra gjykon shumë çështje si gjykatë e shkallës së parë dhe në rutinën/në karakterin e saj si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrton çështjet mbi bazën e ankimit dhe do ndalesha specifikisht. Për çështje që lidhen me aktet individuale që miraton ky Këshill i nderuar, aktet individuale që miraton Këshilli i Lartë i Prokurorisë, aktet që miratohen nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, janë të gjitha çështje të ligjit që kanë aktivizuar juridiksionin fillestar të Gjykatës Administrative të Apelit për t'i shqyrtuar këto çështje, që sigurisht kanë, e para një interes publik, sigurisht në çështjet, do ta veçoja këtë pjesën e shqyrtimit të akteve nga KED-ja për të cilat ligji parashikon që marrin formë të prerë dhe janë përfundimtare, pra nuk mund të rekursohen në Gjykatën e Lartë, pra kërkojnë një vëmendje të veçantë gjykimi, kërkon një përkushtim të trupës gjyqësore për t'i shqyrtuar këto raste me impakt të ndjeshëm në ecurinë në karrierë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sigurisht edhe për akte që miraton ky Këshill i nderuar, KLP-ja në promovimin e magjistratëve në rastet që kundërshtohen aktet e nxjerra.

Dua ta lidh këtë specifikë me legjislacionin e ri, pra Gjykata Administrative e Apelit u ndesh me një paketë të re të reformës në drejtësi të viti 2016. Na u desh kohë ne të përshtatemi të kuptojmë frymën e ligjit, objektivat për të cilat ishin miratuar; në pritje edhe të akteve normuese nënligjore të institucioneve të reja të krijuara në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi.

Çështje të tjera që Gjykata Administrative si shkallë e parë janë prokurimet publike. Në vitin 2021, periudhë për të cilën po vlerësohem, ka hyrë në fuqi ligji i ri për prokurimet publike. Është Gjykata Administrative e Apelit që i shqyrton si gjykatë e shkallës së parë. Një volum i konsiderueshëm aktesh, çështjesh, legjislacioni i ri që kërkon kohë për t'u azhurnuar dhe për të kuptuar mënyrën se si do të zbatohet, me shumë rëndësi dhe me shumë impakt në menaxhimin e fondeve publike. E gjitha kjo përkthehet në kohë për studim, në kohë për vendimmarrje, në kohë për t'u gjykuar dhe dedukton pastaj në pjesën e arsyetimit të vendimit. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton si gjykatë e shkallës së parë çështjet e kompensimit financiar në kuadër të procesit të

kthimit dhe të kompensimit të pronave dhe këto zënë një ngarkesë të konsiderueshme në gjykimin e çështjeve si gjykatë e shkallës së parë. Pra kjo procedurë gjykimi na zhvendos totalisht nga riti i zakonshëm i gjykimit në apel sepse ne jemi ndërthurur midis shumë juridiksionesh. Kjo veçoria që na dallon nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe nga gjykatat e tjera të posaçme.

Do doja të vija në dukje një karakteristikë tjetër të gjykimit administrativ, që është legjislacioni në dinamikë të vazhdueshme. Përgjithësisht legjislacioni administrativ përfshin sigurisht një sërë fushash të së drejtës publike, arsye për të cilën dalin në mënyrë të vazhdueshme për shkak të këtij delegimi me rezervë ligjore autorizohet organi kompetent që një çështje që nuk është rregulluar në ligj, ta rregullojë me akt nënligjor normativ, që mund të jetë vendim i Këshillit të Ministrave, mund të jetë rregullore, urdhëresë, akte të brendshme, që kërkojnë kohë për t'u studiuar, për të hulumtuar; kush është norma që zgjidh specifikisht një çështje të caktuar, dhe po flasim për çështje që kanë një impakt të ndjeshëm në mbrojtjen e interesit publik (tatime, dogana, legalizime, aktet e marrjes së tokës në pronësi, problemet e shumta me regjistrimin e pasurive të paluajtshme). Të gjitha këto, edhe një herë, kërkojnë kohën e duhur që gjyqtari administrativ do duhet t'i kushtojë studimit të akteve nënligjore, përpos akteve voluminoze që përgjithësisht kanë çështjet administrative, që për nga natyra janë çështje komplekse, janë çështje që kërkojnë studim të thelluar dhe azhurnim të theksuar. Për shkak të natyrës që kanë veprimtaritë publike që shqyrton Gjykata Administrative e Apelit na është dashur kohë për t'u azhurnuar (siç e thashë), për shembull po i marr konkretisht, hyri në fuqi Kodi i ri Doganor, me një qasje tërësore nga direktivat e Bashkimit Evropian; hyri ë fuqi Kodi i ri i Procedurave Administrative, që për nga rëndësia vetë legjislacioni parashikon që hyn në fuqi 6 muaj, 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare; ligji "Për vlerën e shtuar" (po i sjell në vëmendje sepse janë raste që na është dashur të ulemi dhe të punojmë në praktikë për të njohur dhe kuptuar zbatimin e këtyre çështjeve).

U ndala mbase pak gjatë këtu, por e vlerësova të nevojshme për të bërë një lloj diference me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ajo që ju me të drejtë si Këshill

keni vlerësuar kur keni bërë, me sa kam dijeni, gjyqtarët e gjykatës së posaçme të apelit (kanë kaluar besoj). Është një gjykatë e posaçme, ashtu është edhe Gjykata Administrative e Apelit, është një gjykatë që ka karakteristika dhe specifika të veçanta.

Unë nuk po ndalem tek efekti që pati procesi i rivlerësimit kalimtar dhe pandemia sepse janë çështje që kanë prekur të gjitha gjykatat, por po ndalem specifikisht dhe konkretisht në praktikën administrative të Gjykatës Administrative të Apelit. Zonja Ukperaj dhe zoti Hado që vijnë nga gjykatat e apelit e dinë praktikën e punës për shkak se menaxhimi i kohës gjyqësore nuk është më përgjegjësi e gjyqtarit në një kohë të jashtëzakonshme ngarkese me çështje gjyqësore. Pra gjyqtari relator mund të ketë hapësirë në kalendarin e tij për ta planifikuar një çështje shpejt për gjykim, ndërkohë është i ndërvarur/i kushtëzuar me planifikimet e anëtarëve të trupës gjyqësore. Në vitin 2021 Gjykata Administrative e Apelit u prek ndjeshëm nga sistemi i procesit të vlerësimit kalimtar, pra patëm 4 shkarkime të njëpasnjëshme, që ndikoi në mënyrën se si u organizua puna. Pra praktika që u ndoq, dhe unë kam sjellë urdhrat e kryetarit të gjykatës, ishte që të gjitha çështjet gjyqësore të planifikuara ose jo për gjykim nga gjyqtari që u shkarkua në këtë proces vetingu, u rishpërndanë. Që do të thotë, përpos ngarkesës që kishte gjyqtari relator dhe për shkak të shkarkimeve që vinin nga vitet e kaluara dhe janë në renditje kronologjike, tashmë iu shtua edhe ngarkesa efektive e gjyqtarëve të larguar, por jo vetëm si gjyqtarë relatorë, por edhe si anëtarë të trupës gjyqësore. Çfarë kërkoi kjo? Kjo kërkoi kohë, e para, për studim, për të mos e ndërprerë vijueshmërinë e procesit sepse ne e thamë, mbulojmë me territor të gjithë Republikën e Shqipërisë, pra palët na vijnë nga (sidomos kur kemi çështje në seanca gjyqësore) rrethe të largëta për t'u dëgjuar dhe ne e vijuam procesin gjyqësor, nuk u bëmë pengesë, duke i studiuar dosjet paraprakisht. Sigurisht, në rastet kur kërkoheshe e nevojshme të dëgjoheshin, u vlerësua, por kjo e ngarkoi gjyqtarin relator me një ngarkesë tjetër. Pra u bënë katër shkarkime rresht dhe u ngarkua efektivisht gjykata me një numër të jashtëzakonshëm çështjesh. Statistikat janë. Unë nuk po i referohem sepse ju i keni përpara. Por viti 2021 ka qenë një nga vitet që e ka pasur shumë të ndjeshme pikërisht rritjen e ngarkesës. Mund të them këtë. Për shembull, në fillim të vitit 2021, unë si gjyqtare relatore kam pasur të

mbartura çështje që i kisha për gjykim (1762 çështje), ndërkohë në fund të vitit 2021 numri u shtua në 3720 çështje (në pritje për t'u gjykuar). E solla këtë për të thënë që ka pasur një rritje të jashtëzakonshme ky vit dhe lidhet pikërisht me mënyrën se si u administrua procesi.

Tjetër për ta sjellë në vëmendje, nga statistikat që ju keni, pavarësisht kësaj ngarkese, unë jam gjyqtarja që kam gjykuar (se qenka e vështirë të flasësh për veten, më mirëkuptoni por më duhet ta bëjë) 154 çështje si gjyqtare relatore, ndërkohë si gjyqtare anëtare (u relatua edhe nga zonja Rupa) 296 çështje. Që do të thotë, në të gjitha çështjet ku gjyqtari është anëtar sigurisht koha është e barabartë për studim, të njëjtën peshë gjykimi kanë, pavarësisht se gjyqtari anëtar nuk ulet në të gjitha rastet për të arsyetuar, por ndodh kur bën shumicën dhe ka pasur raste që kam arsyetuar edhe shumicën (por ka pasur edhe pakicë), ngarkesa për gjykim është e njëjtë, koha për studim është e njëjtë, çështja e dëgjesës së palëve është e njëjtë. Megjithatë, sërish dua të evidentoj, në këtë ngarkesë që kam si gjyqtarja që kam gjykuar numrin më të lartë të çështjeve dhe kjo ka ndodhur po ta shikoni, ndër vite, jam nga gjyqtaret që kam gjykuar shumë çështje në raport me gjyqtarët e tjerë, janë 18 juridiksione fillestare, janë këto çështje që ne i gjykojmë si shkallë e parë për nga rëndësia, ku përfshihen edhe aktet nënligjore dhe normative, ka një peshë specifike gjykimi.

Përveç urdhrit, megjithëse në aktet tuaja të miratuara nga ana juaj ju e keni që nuk sillen prova vendimet gjyqësore, por ne kemi trajtuar aktet individuale, përveç Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve gjyqësorë që janë dy raste, janë aktet individuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor (disa magjistratë), Këshilli i Lartë i Prokurorisë, janë çështjet e vlerësimit e kompensimit financiar, çështje që njëra prej tyre është përzgjedhur edhe me short si në rastin konkret. Nëse ju i doni, jua sjellë edhe në dispozicion.

Arsyeja pse nuk i solla është se nuk pranoheshin vendime gjyqësore. Por unë po them që janë dy akte nënligjore, dy herë Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve në raport me një vendimmarrje tjetër.

(Zonja Plaku dhe zonja Ukperaj flasin pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Brikena, të lutem!

Brikena Ukperaj: .... për ta specifikuar që, në tabelën nr. 4 që janë 18 çështje të juridiksionit fillestar, vetëm 1 është akt nënligjor. Çështja tjetër është e periudhës 2013–2016.

{...}: Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve kisha përshtypje që është e kësaj periudhe. Megjithatë janë të evidentueshme.

Ajo që dua të sjell në vëmendje, e kam sjellë kalendarin e punës dhe e kam sjellë për të thënë që sa e pamundur ka qenë për të planifikuar çështje gjyqësore, në atë ngarkesë të jashtëzakonshme që ka pasur Gjykata Administrative e Apelit. Në fund të vitit 2021, ne ngelëm me 5 gjyqtarë. Pra e nisëm me 9 gjyqtarë. Ishim të organizuar në tre trupa gjyqësore të qëndrueshme. Në fund të vitit 2015, me 5 gjyqtarë nuk organizonim dot një treshe të qëndrueshme. Pra treshja ku isha unë pati një kolege të shkarkuar në procesin e vetingut, ndërkohë duhet të prisnim që të liroheshe një gjyqtar nga trupa e qëndrueshme, që të formonim treshen. Plus, kemi pasur gjyqtarë kanë qenë të angazhuar në procesin e rivlerësimit kalimtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit por edhe në shkallën e parë të procesit, të angazhuar me përgjigjet e pyetësorëve, me pjesëmarrje në seanca dëgjimore, kohë e cila i ka penguar ata për të qenë efektivisht. Ndërkohë dua ta evidentoj që nuk jam bërë pengesë në asnjë rast për dështimin e seancave gjyqësore. Kam qenë korrekte, sikurse u evidentua në fakt edhe në relacionin që ju parashtruat.

Tani, për t'u lidhur pak me çështjet konkrete.

Në relatimin tuaj, në një nga çështjet për të cilat është kërkuar marrja e masës së sigurimit të padisë, Gjykata Administrative e Apelit shqyrton edhe kërkesat e marrjes së masës së sigurimit të padisë, ka rezultuar që një kërkesë e tillë është paraqitur në muajin gusht në datë 9.08.2021. Është pikërisht çështje administrative me nr. 878 regjistri themeltar (e regjistruar në datë 09.08.2020). Kjo çështje është konsideruar nga ana juaj si çështje në tejkalim të afatit ligjor 5-ditor. Unë po ju parashtroj që ka qenë pamundësi absolute për ta shqyrtuar këtë çështje. Megjithatë nuk e dëgjova në relatim. U ndërpre

leja, sepse unë isha e planifikuar me gatishmëri, ndërkohë nuk kisha dy gjyqtaret e tjera që ishin në kohën e periudhës së lejes vjetore. Në çështjen tjetër të regjistruar si juridiksion fillestar (citohet emri), çështja me nr. 161 regjistri themeltar, nuk është konsideruar në analizën që ju keni bërë në projektraport (sepse është gjykuar si çështje e gjykatës së shkallës së parë) koha e pezullimit të proceseve gjyqësore për shkak të pandemisë Covid 19, sipas aktit normativ nr. 9, 20.03.2020, pra është konsideruar jashtë afatit.

Unë po e sjell në vëmendje sepse nuk e dëgjova as në parashtresë, por nuk e kam as në projektraport. Por është një çështje që ka kaluar afatin për shkak se ka qenë e pezulluar veprimtaria e Gjykatës Administrative të Apelit në këtë kohë.

Në dy vendime gjyqësore ku konsiderohet dorëzimi jashtë afatit 7-ditor, po e theksoj edhe një herë, është një afat shumë i shkurtër afati 7-ditor, por kështu ka mbetur, ka pasur mendime në pakicë në dy nga çështjet e përzgjedhura me short nga ana e grupit të punës, pra qoftë në çështjen e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë ka pasur mendim pakice dhe çështja që citova tani për shkak të pezullimit të afateve ka pasur një gjyqtar në pakicë, është dashur kohë që gjyqtari kundër të marrë vendimin e shumicës dhe të arsyetojë përfundimin e arsyetimit të tij (pra pjesën e mendimit të pakicës).

Një specifikë tjetër e gjykimit në apelin administrativ që lidhet me kohëzgjatjen, me rendimentin sa i përket respektimit të afateve ligjore. Ne kemi një praktikë administrative që na i dikton Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në lidhje me kalimet procedurale. Për shkak se ka kaluar një kohë e konsiderueshme nga gjykimi i çështjeve në shkallë të parë, shumë organe publike kanë ndryshuar emërtesën, shumë organe publike janë suprimuar, kanë marrë kompetencat e organeve të tjera. Për shkak të kësaj praktike të kolegjit administrativ, ne jemi të detyruar që në dhomë këshillimi të bëjmë kalimet procedurale duke njoftuar rregullisht të gjitha organet publike që kanë marrë kompetencat e organeve të tjera të suprimuara apo të kaluara kompetencat. Kjo është kohë sepse nominalisht do duhet të njoftohen të gjitha organet e reja publike, për të kuptuar që tashmë janë në një proces gjykimor administrativ, mbi objektin e të cilave heqin të drejta dhe detyrime. Kjo ndikon në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore.

Kohëzgjatja tjetër e proceseve që nuk lidhet me përcaktimet e ligjit deri në një moment të caktuar është dhënia kohë palëve për plotësimin e të metave të ankimit. Specifikat e gjykimit në apel, që tashmë janë unifikuar procedurat, ankimi kalon në dy filtra. Është gjyqtari i shkallës së parë që bën filtrin e parë dhe gjykata e apelit, sigurisht, detyrimin ligjor të parin ka të verifikojë kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Nëse nuk e ka bërë gjyqtari i shkallës së parë, ankimi nuk përmban shkaqe që është situata më e rëndomë që na ndodh, nuk ishte rregulluar kjo çështje me ligjin deri në vitin 2021, tashmë e kemi të rregulluar, përpara kësaj praktike, Kolegji Administrativ diktoi për Gjykatën Administrative të Apelit praktikën që do duhet t'i jepet kohë palës për të plotësuar të metat e ankimit, për t'i garantuar një proces të rregullt ligjor edhe në gjykimin administrativ. Kjo kërkon kohë. Pra nëse palës i jepet mundësi të plotësojë të metat e ankimit (dhe ka pasur disa çështje në rastin konkret), ky komunikim i plotësimit të metave të ankimit është bërë edhe për palët që nuk kanë dijeni për shkaqet e ankimit, është bërë për Avokaturën e Shtetit. Janë të gjitha njoftime individuale që diktojnë kohëzgjatjen e procesit, pra janë të gjitha të palidhura me vullnetin e gjyqtarit administrativ.

Të kthehemi pak tek metodologjia, sepse dëgjova në relatimin tuaj znj. Rupa që nuk është ngritur çështja e metodologjisë së vlerësimit sipas vendimit nr. 261 të vitit 2010 të KLD-së në projektin e parë. Nuk e kam ngritur sepse në "Aftësinë organizative", në rubrikat isha vlerësuar maksimalisht, jo se nuk ishte një çështje për t'u ngritur, por mendova, duke debatuar problematikat e njëjta që ka procesi, do ta thoja pikërisht këtu. Në vlerësimin tim (Këshilli vlerëson dhe gjykon), por unë mendoj që ai akt normativ i referohet një kuadri tjetër ligjor, i një kohe të zakonshme (sikurse e thatë) funksionimi të gjykatave. Nuk mund të aplikohet në situatën që sot po kalon sistemi gjyqësor, në një situatë të jashtëzakonshme; në një situatë ku në një numër shumë të reduktuar gjyqtarësh je i detyruar t'i përgjigjesh një fluksi shumë të madh me çështje gjyqësore. Gjyqtarët anëtarë të nderuar të Këshillit po edhe ata që kanë në familje gjyqtarë tashmë në sistem, e kuptojnë se si është situata sot. Duhet të jesh në gjykatë të kuptosh se sa... në një situatë të jashtëzakonshme nuk mund t'i kërkohet gjyqtarit numra, teknikalitete dhe

kohëzgjatje gjykimi sepse është e evidentueshme dhe unë s'po ndalem. Kemi disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, kemi disa vendime të kolegjit civil dhe kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë që në shqyrtimin e kërkesave për tejkalimin e afatit të arsyeshëm, kanë sjellë në vëmendje pikërisht këtë situatë të pazakontë që ka diktuar procesi i rivlerësimit kalimtar, pra numri i reduktuar i gjyqtarëve në raport me numrin e madh të çështjeve për gjykim.

Ta them edhe këtë dhe do ta mbyll. Mbase kaloi.

Përpos gjithë këtij angazhimi maksimal në detyrë, duke qenë se kam gjykuar numrin më të lartë të çështjeve dhe kam vlerësuar si detyrim, si përgjegjësi që t'i përgjigjem thirrjes së Shkollës së Magjistraturës. Nga vetë ky Këshill i nderuar është rritur numri i studentëve për t'u rekrutuar si magjistrat prokuror dhe gjyqtar. E kam vlerësuar si detyrim por kjo nuk është bërë pengesë për ecurinë e proceseve gjyqësore. Unë kam përgatitur materialin, edhe në trajnimet vazhduese kur kam qenë e ftuar si eksperte, sepse e kam nisur nga lehtësuese këtë rrugë, por kam përgatitur materiale edhe për studentët e Shkollës së Magjistraturës. Të gjitha këto i kam dërguar me të drejtën e botimit në shkollë duke mos pasur mundësinë për t'u ulur dhe për të bërë diçka, për t'i shërbyer praktikës (dhe ato, sikurse i relatuat, janë dërguar). Fati e deshi që njëri prej atyre shkrimeve të botohet në revistën e Shkollës, por kjo sigurisht nuk është bërë pengesë. Unë e kam ndjerë si vlerësim për ta dhënë këtë kontribut modest në drejtim të praktikës gjyqësore që lidhet me specifikat e gjykimit administrativ.

Ju falënderoj për dëgjesën dhe jam në dispozicionin tuaj nëse keni pyetje.

Naureda Llagami: Në fakt unë kam pyetje.

Sepse ju e dini shumë mirë që Gjykata e Apelit Administrativ sot po përballet me një backlog shumë të madh dhe ne këtu si Këshill kemi përgjegjësi për sa i përket backlog-ut dhe po mundohemi të gjejmë mekanizma. Fjala kyçe e të gjithë mekanizmave që ne po përpunojmë për gjykatat është backlog-u. Duke qenë se ju jeni një gjyqtare me karrierë, kush janë metodologjitë që mund të ndihmojnë në backlog? Sepse po t'ju shohim në numra, po t'ju shohim në stafin që ju keni, të paktën unë në cilësinë e

kryetares së Komisionit të Administrimit, jeni një nga gjykatat, që duhet ta pranojmë, keni një numër ndihmësish ligjorë, jeni një gjykatë e cila jeni prekur nga vetingu, pa diskutim, siç janë prekur të gjithë gjykatat e tjera, por të gjithë shqetësimet që mua më vijnë nga i gjithë publiku, lidhet me pjesën e çështjeve që flenë dhe si mundet që ne ta adresojmë. Unë kam qenë vetë edhe tek analiza juaj. Unë dua të kuptoj kush janë problemet që ne mund t'i adresojmë për pjesën e reduktimit të backlog-ut? Sepse tashmë ne duhet të mendojmë për strategji si të heqim backlog-un. Kjo është një sfidë dhe është e vetmja mënyrë që ne kemi për gjyqtarët. Po të shohim të gjithë kuadrin tonë ligjor, vlerësimi i gjyqtarit është i vetmi mekanizëm, në mënyrë shumë të tërthortë, ku ne mund të ndikojmë në përmirësimin e punës së gjyqtarit, por nga ana tjetër ne mund të ndikojmë pse jo edhe tek nxitja që gjyqtari të punojë më shumë. Ky është mekanizmi që ka Këshilli. Nuk ka mekanizëm tjetër. Pavarësisht se mua më rezultonin gjykata me performanca të ndryshme, por prapë kur kthehemi këtu në Këshill, themi që nuk kemi asnjë mekanizëm që ne këto gjykata, përveçse t'i mbështesim në burime njerëzore, gjë që të paktën unë për sa kohë që kam qenë në cilësinë e kryetares së këtij Këshilli dhe gjithë kolegët e mi, gjëja primare që kemi pasur që ditën e parë ka qenë si të mbështesim gjykatat, si në infrastrukturë, si në burime njerëzore, në të gjithë komponentët e tjerë që një gjykate i nevojitet për të pasur performancë më të lartë. Kështu që unë për këtë doja një mendim nga ana juaj, çfarë duhet të bëhet në Gjykatën e Apelit Administrativ, me qëllim që kjo gjykatë të jetë efektive në pjesën e gjykimit të çështjeve? Për çfarë strategjish ka nevojë atje?

{...}: Faleminderit zonja Kryetare!

E vlerësoj pyetjen edhe marrjen e mendimit.

Në fakt situata nuk është e pazakontë, specifikisht lidhet me Gjykatën Administrative të Apelit. Ne tashmë kemi ende për gjykim çështje të vitit 2016. Për shkak të dhënies përparësi gjykimit të çështjeve, ne i kemi rishpërndarë të gjitha edhe një herë për rishortim për të mos mbetur tek një gjyqtar i vetëm të grupuara. Imediate është shtimi i numrit të gjyqtarëve. Pra, një trupë gjyqësore aktuale me gjashtë gjyqtarë (që

formojmë dy trupa gjykues), – kjo është një gjë që lidhet me gjithë sistemin dhe unë po e parashtroj për shkak të rëndësisë që ka, që është parësore.

Së dyti, do të duhet mbase që me autoritetet publike përgjegjëse, sikurse po veprohet me rekurset në Gjykatën e Lartë për të cilat një pjesë e mirë janë tërhequr rekurset, nuk po reflektohet në Gjykatën Administrative të Apelit. Pra nëse për të njëjtën linjë qëndrimi, për pensionet e pleqërisë kemi një aktivizëm të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore (janë tërhequr rekurset), nuk po ndodh kjo në Gjykatën Administrative të Apelit.

Për çështje të cilat kanë vlerën e vogël të objektit të kërkimit, janë çështje që... *(lë mendimin përgjysmë*). Se doli, ne gjykojmë me trup gjyqësore të përbërë me 3 dhe 5 gjyqtarë, ndërkohë gjykatat e apelit të juridiksionit të zakonshëm, një kategori të caktuar çështjesh i gjykojnë si gjyqtar i shkallës së parë. Mund të bëhet kjo edhe në Gjykatën Administrative të Apelit me një ndryshim ligjor. Për shembull, urdhrat e ekzekutimit mund të shqyrtohen me një gjyqtar; Kushtet e pranueshmërisë së ankimit apo të rekursit mund të shqyrtohen me një gjyqtar; Çështjet që kanë një vlerë të vogël monetare për të shkuar në paralelizmin në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

Stafi administrativ që asiston Gjykatën Administrative të Apelit, është shumë e rëndësishme që të vihen kritere përzgjedhëse në metodikën e përzgjedhjes por edhe të cilësive të nivelit të kualifikimeve profesionale, të ndihmësve ligjorë që asistojnë. Të mos e bëjë gjyqtari administrativ i apelit vendimin për ta fokusuar nga pjesa hyrëse, në analizën e fakteve, sepse është një konsum i jashtëzakonshëm për gjyqtarët. Pra një staf i specializuar mbi kritere të mira përzgjedhëse, do t'i vinte shumë në ndihmë ecurisë dhe futjes në normalitet të punës në Gjykatën Administrative të Apelit.

Naureda Llagami: Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Përshëndetje, zonja {...}!

Ajo që mua më bën përshtypje është fakti që ju në vitin 2013–2016 keni normën e likuidimit 500 e ca çështje në vit, pa llogaritur këtu pjesëmarrjen tuaj në trupa gjykues.

Çka sipas një informacioni më rezulton që keni gjykuar edhe 30 dhe 45 dhoma këshillimi në ditë. Keni qenë 7 gjyqtarë. Nuk keni pasur këshilltarë ligjorë. Keni bërë çdo gjë ju.

Vijmë në vitin 2021. Deri në fund të vitit (në nëntor) keni qenë 6 gjyqtarë (pra 1 gjyqtar më pak se viti 2013 – 2016 deri kur erdhën ndihmësit). Keni pasur nga dy këshilltarë (një këshilltar e gjysmë). Unë nuk e kuptoj, se nëse ju vazhdoni prapë t'i bëni të gjitha këto, çfarë bëjnë këshilltarët? Si shpjegohet që ju nuk nxirrni çështje? Nuk është çështja se sa gjykoni. Unë kam qenë edhe tek analiza juaj. Kjo është një gjë që i bie në sy çdo gjyqtari, por edhe një njeriu që ndoshta nuk ka njohuri nga fusha juridike dhe nga mënyra se si administrohet një gjykatë, që Gjykata e Apelit Administrativ nuk nxjerr çështje për gjykim. Nuk është vetëm çështja që "se sa mbaroj", "s'kam mbaruar sepse kam pasur çështjet të kolegëve të tjera që i kam pasur në treshe". Nga ana tjetër, kur dëgjuam këshilltarët, nuk na u dukën që ishin ata pengesa që çështjet nuk dalin, sepse këshilltari thotë "unë përpunoj aq çështje sa gjyqtari më ngarkon, dhe ne kemi punuar thanë ata edhe 60 dhe 80 çështje".

Juve vërtet keni gjykuar më shumë se të gjithë gjyqtarët e apelit administrativ, por diferencat nuk janë diferenca uau. Po të krahasoheni me një gjyqtare tjetër, kryetaren, ju keni gjykuar vetëm 3 çështje më shumë se kryetarja, ndërkohë ajo ka edhe ngarkesa të tjera, ose edhe nga gjyqtarët e tjerë. Pra nuk është një tregues që tejkalimi i standardit sasior të vendimeve tuaja, si numër vendimesh, është aq i madh sa të kihet parasysh në pjesën e trajtimit të diferencuar. Unë mendoj që kjo është diçka që juve ju afekton të gjithëve gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Administrativ. Nga ana tjetër, ligjet tuaja vërtetë janë ligje që janë në dinamikë, ju duhet patjetër që të thelloheni, por mos harrojmë që gjyqtarët e juridiksionit të përgjithshëm gjykojnë çështje të të gjitha fushave (familjare, tregtare, civile) dhe ju vë në vëmendje që sigurisht jo të gjitha kanë kompleksitet dhe që duhet të thellohesh, sepse ke edhe një praktikë që ndoshta.. por ka edhe aty çështje. Nga ana tjetër, ata gjyqtarë, ndryshe nga ju, në vitin 2021 kanë lëvizur në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, që është një ngarkesë tjetër për gjyqtarin, dhe kur shikojmë treguesit statistikorë të këtyre gjyqtarëve, shikojmë që kanë mbi 500 çështje të gjykuara si relatorë, pastaj me gjithë trupin gjykues shkojnë në 1.000 çështje. Pra është një

diferencë e theksuar, që pavarësisht dinamikave të legjislacionit, pavarësisht procesit të rivlerësimit kalimtar, aty ka diçka që nuk shkon.

Si është situata?

{...}: Faleminderit zonja Ukperaj për pyetjen!

Më dhatë mundësinë edhe të shpjegohem edhe më në detaje dhe për të bërë një lloj krahasimi. Po, është e vërtetë. Në periudhën 2013 – 2016 ne në raport me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kemi qenë nga gjykatat që kemi gjykuar shumë çështje dhe janë evidente në projektvlerësim. Ritet e gjykimit në apelin administrativ është dhoma e këshillimit, sigurisht është gjykim mbi aktet, gjykim komod le të themi nga pikëpamja e gjyqtarit sepse në fund të fundit po shqyrton një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë që për nga natyra e gjykimit administrativ është lehtësisht e verifikueshme mbi akte. Përgjithësisht gjykimet e para, qoftë edhe me mungesën e ndihmësve, ishim të fokusuar në këtë rit gjykimi. Pra gjykimi në dhomë këshillimi ka komoditetin që gjyqtari të planifikojë paraprakisht të studiojë dosjen dhe në dhomë këshillimi ka ardhur i konkluduar me të gjithë anëtarët e trupës sepse është dërguar relacioni paraprakisht, është dhënë mundësia të shikohet dosja. Çfarë ndodhi në vijim?

Kemi një sërë çështjesh të prishura nga Gjykata e Lartë, Kolegji Administrativ, të kthyera për rigjykim në gjykatën administrative të apelit me detyra konkrete, për hetim të plotë gjyqësor, detyra të cilat nuk mund të realizohen në dhomë këshillimi. Është e nevojshme që gjykata të kalojë në seancë gjyqësore dhe t'ia nënshtrojë debatit gjyqësor të gjitha çështjet e ngritura. Së dyti, shumë ligje (e citova jo pa qëllim), ligjet e reformës në drejtësi dhe ligjet e mëvonshme që u miratuan e bënë gjykatën administrative të apelit si gjykatë të shkallës së parë, pra në një farë kuptimi ia humbën atë sensin e gjykimit si gjykatë e shkallës së dytë ose ia minimizuan. Pra duke qenë se jemi gjykatë (nga 2016 e këtej po flasim) që gjykojmë edhe si gjykatë apeli, por edhe si gjykatë e shkallës së parë, sigurisht kjo dikton/afekton në mënyrën e programimit të çështjeve, pra je i kushtëzuar tashmë edhe nga një profil tjetër gjykimi, që do duhet të marrë rëndësinë e vet në këtë proces.

E citova jo pa qëllim sigurisht që të gjithë gjyqtarët janë të impenjuar të përballojnë një numër të madh çështjesh por kjo lidhet me pamundësinë absolute të planifikimit të çështjeve. Pra po të shikoni kalendarin që unë e kam sjellë, janë çështje në seancë gjyqësore; janë çështje të programuara nga ora 8:30 e mëngjesit, ndonjëherë më herët, deri në orën 15:30. Po çfarë ndodh? Kjo sjell efektin zinxhir, duke qenë një trupë shumë e reduktuar pret jashtë gjykatës të bëhet procesi, ndonjëherë kanë kaluar edhe oraret zyrtare të gjykimit, sepse ka qenë pikërisht kjo ngarkesa e gjykatës me gjykime që e ka pasur të pamundur edhe ta fillojë gjykimin në orar, por për një drejtësi efektive, për shkak të faktit që palët vijnë nga e gjithë Shqipëria, ne kemi vijuar procesin. Po të shihni kalendarët, është pamundësi absolute e planifikimit të çështjeve në një numër siç do donim ne të ishte.

E dyta, në raport me gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, do ishte komoditet për gjyqtarin administrativ të gjykonte disa çështje me një gjyqtar të vetëm. Ne jemi të diktuar në të gjitha çështjet me treshe gjyqësore, me pesë gjyqtarë. Pra e ke të pamundur të planifikosh nëse kolegu nuk ka hapësirë për të planifikuar një çështje për gjykim. Të gjitha këto janë faktorë që bëjnë këtë trajtim të diferencuar.

Brikena Ukperaj: Nga një llogaritje e momentit më rezulton që 154 çështje, në fakt mbi 100 çështje janë gjykuar në dhomë këshillimi. Rreth 103 çështje janë të gjykuara në dhomë këshillimi.

{...}: Ajo është pjesa – le të themi – komode e gjyqtarit administrativ për të gjykuar. Pjesa tjetër është angazhim në treshe gjyqësore, në gjykime me pesë gjyqtarë, që thashë për nga rëndësia zgjasin 2-3 orë, gjykimi i një akti normativ merr peshën e vet. Është e rëndësishme të dëgjohen të gjithë autoritetet publike. Përpos kësaj gjyqtari administrativ ka edhe një ngarkesë tjetër që do duhet ta them, është një gjyqtar garantist, në një ekuilibër interesi publik, në raport me cenimin e të drejtave të interesave privatë. Jo se gjykatat e tjera janë të parëndësishme, por ka një peshë specifike gjykimi në apelin administrativ.

(Nuk ka më pyetje nga anëtarët e Këshillit.)

Naureda Llagami: Ju falënderoj për prezencën në seancë. Mund të vazhdoni për të lejuar Këshillin.

{...}: Edhe unë ju falënderoj për kohën dhe për dëgjesën.

Faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtarja {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Yllka, thjesht për korrektesë. Ju keni propozuar rritjen e 5 pikëve.

Yllka Rupa: Po, tek pjesa e "publikimeve ligjore". Është pjesë e vlerësimit të përgjithshëm.

(Rifillon diskutimi.)

Naureda Llagami: Atëherë, pasi dëgjuam edhe gjyqtaren, unë ftoj kolegët nëse kemi propozime konkrete mbi projektraportin, përveç propozimit që vetë relatorja e dha.

Po, zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit Kryetare!

Në radhë të parë unë dua të komplimentoj nëpunësit përgjegjës të cilët kanë përpiluar këtë, bashkë me relatorin, për punën që është kryer, si dhe për relatimin e sotshëm që ishte shumë konciz, shumë i saktë dhe shumë shterues në ato që tha. Por nga ana tjetër, unë dua të ndalem tek problematikat, ashtu siç e filloi edhe gjyqtarja, që

ekzistojnë në një kategori të këtyre gjykatave, siç është gjykata e apelit administrativ, që nuk është një gjykatë e juridiksionit të përgjithshëm.

Për vetë mënyrën e krijimit të kësaj gjykate, unë për fat kam qenë atëherë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për fat për mua, ndoshta sot nuk është mirë me qenë atëherë, por për mua ka qenë fat i madh, eksperiencë e madhe kur janë krijuar këto gjykata dhe dimë synimin se përse u krijuan, dimë pse u bënë dhe cili ishte synimi. Pra të kishte një evadim më të shpejtë të dosjeve, shqyrtimi të ishte më i shpejt, në një kohë më të shkurtër dhe të ishin më efektiv në këtë problematikë. Dhe ndodhi ajo që ndodhi që ne sot e dimë situatën në të cilën ndodhën.

Duhet të keni parasysh që kjo gjykatë apeli është filtri që vjen nga të gjitha gjykatat e shkallëve të para administrative, pra do të shqyrtonte të gjithë gamën e këtyre çështjeve. Duhet të kemi parasysh gjithashtu faktin që regjistrimi i dosjeve fillon nga momenti që dalin nga shporta e famshme (në zhargonin e përditshëm), pra dita e nxjerrjes së dosjes që caktohet për gjykim; Duke pasur parasysh tematikën që shqyrtojnë, që janë akte ligjore/nënligjore, shqyrtimin e kundërshtimeve të urdhrave, urdhëresave, akteve nënligjore normative, nxjerrjes së shumë vendimmarrjes së institucioneve të pavarura, siç kemi të bëjmë me institucionet KLGJ, KLP, apo të gjithë të tjerat, të cilat janë një afat kohor të përcaktuar në ligj më të shpejt se sa çështjet e tjera që gjykohen; Duke pasur parasysh edhe faktin tjetër që këto gjykojnë me tre apo me pesë gjyqtarë, pra nuk gjykojnë vetëm; të gjitha këto problematika, pa rënë në përsëritje, se janë thënë e stërthënë nga gjyqtarja si dhe nga materialet që na janë paraqitur; duke bazuar këtë edhe me pjesën e gjyqtares tashmë, pasi këto ishin problematika që ka sistemi i gjykimit administrativ dhe kryesisht në apel, duhet të kemi parasysh që kjo gjyqtare, të paktën nga analiza që na është paraqitur, nga analiza vjetore e gjykatës, si relatore ka 154 çështje të përfunduara. Si anëtare në trup gjykues u tha një shifër 296. Duhet të kemi parasysh që 296 si anëtare është e njëjta votë si relatori, ka firmën aty dhe mban përgjegjësi për gjithçka që thotë. Kështu që për mendimin tim të gjitha këto duhet të reflektohen tek numri i dosjeve që ajo ka shqyrtuar apo ka përfunduar në këtë vit kalendarik.

Gjatë vitit 2021 në gjykatën e apelit janë shqyrtuar në total 887 çështje të natyrës administrative të përgjithshme, marrëdhënie pune si dhe çështje të juridiksionit fillestar.

Ashtu siç tha edhe relatorja, duhet t'i përfshijmë të gjitha këto dhe të shohim sa del rendimenti i kësaj gjyqtareje pastaj. Ashtu siç tha edhe vetë gjyqtarja, ndikoi në punën e saj edhe fakti i procesit të vetingut. Nga aktet që na janë paraqitur, unë konstatoj që brenda këtij viti, pra vetëm brenda vitit 2021 janë katër gjyqtarë të shkarkuar nga procesi i rivlerësimit kalimtar, të cilët kanë ndikuar në punën e çdo gjykate, dhe aq më tepër, nëse ty të takon që të jesh në trup gjykues me këto gjyqtarë, pasi çështja do rinumërohet, do fillojë nga fillimi, do të futet tek ajo e famshmja shportë apo do vazhdojë menjëherë në atë moment; dhe të gjitha këto afektojnë pastaj në sasinë dhe cilësinë e punës së gjyqtares.

Shoh kalendarin e gjyqtares, të cilën e ka paraqitur si provë, nëse s'kemi akt tjetër që ta kundërshtojmë për të falsifikuar apo për ndonjë akt që është personal, por që nuk mund ta kundërshtojmë, shohim që këtu janë të nxjerra oraret, minimumi 13 seanca në ditë. Kapni cilin muaj, të paktën këtë që ka servirur vetë kolegia jonë.

Pra duke parë të gjitha këto, duke pasur parasysh faktin që kemi të bëjmë me një juridiksion të veçantë, është hera e parë që ne vlerësojmë këtë kategori dhe duhet të bëjmë shumë kujdes për sa i përket vlerësimit të këtyre gjyqtarëve, të cilët për hir të vërtetës dalin në punë, sakrifikojnë, punojnë, por nga ana tjetër janë edhe njerëz, kanë edhe familje, janë edhe kryefamiljarë, në gjithë këtë problematikë të sotme të sistemit që ne kalojmë, ne shohim që gjyqtarja, duke pasur unë personalisht edhe njohjen si anëtar i vjetër i KLD-së dhe gjyqësor dhe njohjet që kemi nga pjesa e emërimit të saj, unë kam vlerësimin maksimal për këtë gjyqtare dhe më bën shumë përshtypje edhe fakti që në vlerësimin e viteve 2013-2016 kjo gjyqtare vlerësohet me 397 pikë ndërsa në procesin e vlerësimit për 2021 vlerësohet me 379 pikë, pra një diferencë e madhe për një gjyqtare të tillë, një gjyqtare që përveç kësaj, dua të theksoj që është edhe pedagoge e jashtme pranë Shkollës së Magjistraturës, e cila pavarësisht detyrave që ka si gjyqtare, mundohet të japë kontributin e saj në sistemin e drejtësisë, në sistemin edhe të mësimdhënies edhe të

përgatitjes së gjyqtarëve, prokurorëve të rinj apo edhe në trajnimet vazhduese të gjyqtarëve që janë në detyrë.

Gjithashtu, në vlerësimin tim, duke pasur parasysh faktin që në rubrikën "Aftësitë organizative të gjyqtares", aftësia e gjyqtares për të kryer procedurat gjyqësore, numri i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme produktive për shmangien e atyre joproduktive dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor është vlerësuar maksimalisht, mua nuk më bën sens se si një gjyqtare e tillë që merr të gjitha masat, punon, angazhohet, cakton seancat gjyqësore, është e angazhuar në mësimdhënie, bën të gjitha këto veprime dhe na del me rendiment shumë të ulët (poshtë mesatares), pra ka diçka që nuk shkon.

Prandaj po kaloj në propozimin tim, për të mos ju lodhur.

Në kriterin "Aftësitë organizative të gjyqtares", "Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë", "Respektimi i afateve ligjore", nga 9 pikë, të rritet, të kalojë në 12 pikë. Pra me një nivel. Nuk po themi maksimalen, por një nivel.

"Plotësimi i standardeve minimale kohore", nga 4 pikë në 5 pikë.

"Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore" (germa ç) të kalojë me 8 pikë.

"Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor" (germa d), nga 6 pikë në 12 pikë.

Këto janë propozimet e mia.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Tjetër koleg?

Kemi më propozime të tjera?

Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Unë po e them paraprakisht që nuk kam propozime të tjera, sepse dakordësohem tërësisht me qëndrimin e mbajtur nga ana e relatores dhe dua të them paraprakisht që për aspektin e aftësive organizative, ne në fakt kemi një qëndrim të mbajtur si Komision,

në kushtet kur gjyqtarja {...} ishte gjyqtarja e parë nga gjyqtarët e apelit administrativ që vlerësohej për vitin 2021.

Do t'ju marrë pak kohë, por nuk dua që të mërziteni.

Fillimisht dua të jap disa konsiderata por edhe si anëtare e grupit që kam marrë pjesë në hartimin e metodologjisë së pikëzimit.

Kur ne hartuam metodologjinë ishim të ndërgjegjshëm që i vetmi kriter objektiv që do të reflektonte në aftësitë profesionale të gjyqtarit ishte kriteri i aftësive organizative sepse aty ne kishim të dhëna të matshme. Nga ana tjetër, ligji na detyronte që kur merrnim dhe analizonim të dhënat statistikore për sa i përket kriterit të aftësive organizative, nuk mund të penalizohej gjyqtari për një rritje të volumit të papritur të çështjeve, nuk mund të penalizohej gjyqtari për shkak të kushteve të punës apo për shkak të arsyeve të tjera që lidheshin gjithmonë me punën, dhe duhet të kemi parasysh që ne gjyqtarin nuk e vlerësojmë për shkak të njohjeve personale që mund të kemi për gjyqtarin sepse gjyqtari këtu vlerësohet për shkak të punës dhe statistikave që merren gjatë procesit të rivlerësimit. Pra vlerësimi duhet të jetë objektiv dhe i bazuar në prova dokumentare.

Çfarë bëmë me kriterin e dytë të aftësive organizative?

Vendosëm kufij standardesh në metodologji dhe i lamë vetes një hapësirë më të lartë diskrecioni. Në ç'kuptim? Në kuptimin që, një gjyqtar që gjykon nuk duhet të penalizohet nga shifra sepse për shembull, në qoftë se në një gjykatë me pak gjyqtarë shkon një numër shumë i madh çështjesh, gjyqtari çfarëdo që të bëjë, 500 do gjykojë. Por ky numër i madh çështjesh do të afektonte sigurisht në rendiment, ën standard, në afate ligjore. Prandaj thamë që për çdo gjyqtar, të bëhet analizë logjike e të dhënave statistikore, në mënyrë të tillë që, gjyqtari, në qoftë se gjykon, është produktiv, nuk duhet të penalizohet nga shifra, duhet që të marrë vlerësimin maksimal. Por ky diskrecion nuk është i pakufijshëm. Ky diskrecion varet nga të dhënat statistikore të gjyqtarit dhe nga ruajtja e një standardi të njëjtë krahasimi midis gjyqtarëve, të paktën jo të të njëjtit niveli por të të njëjtës fushë. Pse e them këtë gjë?

E them këtë gjë sepse Gjykata e Apelit Administrativ sigurisht është një gjykatë e posaçme dhe që gjykon çështje të një shkalle kompleksiteti të konsiderueshme. Por nga

ana tjetër këto çështje, asaj i shkojnë nga gjykata e shkallës së parë (një pjesë, se ka çështje të juridiksionit fillestar). Këto detyrime nuk janë vetëm për gjyqtarin e apelit administrativ, janë edhe për gjyqtarin e gjykatës së shkallës së parë administrative. Kur kemi vlerësuar gjyqtarët e shkallës së parë administrative (mbaj mend Durrësin apo Tiranën) të cilët kishin një numër shumë të madh çështjesh, asnjëri nuk është penalizuar për rendiment. Pse? Sepse ata gjykonin 800 çështje, 900 çështje. Dhe çfarë t'i thuash gjyqtarit në qoftë se duhet të gjykojë 300 dhe gjykon 800. Ai nuk gjykon dot më shumë, dhe gjykon më shumë seç duhet. Pra tejkalonin standardin me dyfish apo trefish. Ama kur bëheshe fjala për afatin ligjor, hapësira e vlerësuesit është më e vogël sepse është ligji që përcakton që ti këtë çështje duhet ta gjykosh për 15 ditë, do ta gjykosh për 5 ditë. Si reflektuam tek gjyqtarët e shkallës së parë administrative? Sepse e njëjta gjë ndodh edhe me gjykatën e apelit kur shkon sigurimi i padisë, apo kundërshtimi i veprimeve përmbarimore apo pezullimi. Në qoftë se gjyqtarit të shkallës së parë i thamë që duhet të kishe treguar më shumë kujdes se në fund të fundit 11 çështje ke pasur të tilla. Të njëjtën gjë duhet t'i themi edhe gjyqtarit të gjykatës së apelit administrativ. Kjo ishte për sa i përket metodologjisë dhe ruajtjes së një standardi.

Lidhur me gjyqtaren {...}. Në fakt unë i bëra edhe pyetje. Ka një ndryshim, ka një dallim të pashpjegueshëm/ të pambështetur vetëm në mënyrën se si rrjedh legjislacioni, ndryshimi i të dhënave statistikore të viteve 2013-2016 me vitin 2021. Në vitin 2013-2016, gjykata nuk ka qenë me 13 gjyqtarë, ka qenë me 7 gjyqtarë (disa muaj), dhe këta 7 gjyqtarë nuk kanë pasur asnjë këshilltar ligjor. Zonja {...}, për këtë periudhë, ka një tregues të shkëlqyer të produktivitetit të punës, 500 e ca çështje mesatarja në vit (528 më saktëson Irena). Në qoftë se vijmë tek viti 2021, kanë qenë 1 gjyqtar më pak, por pothuajse nga dy këshilltarë secili gjyqtar. Sigurisht që pa i mohuar kurrsesi punën e madhe studimore, kërkimore të gjyqtarit administrativ për të zgjidhur një çështje, këshilltari është ndihmë. Por edhe nëse nuk është ndihmë, pse vetëm 150 çështje? Dhe për t'i dhënë përgjigje asaj që zoti Hallunaj thotë. Po, unë e gjej një zgjidhje. Nuk nxirren çështje për gjykim. Është shumë e thjeshtë. Kalendari i gjyqtares është po aq i mbushur sa edhe me data për studim dosjesh. Se e kam parë dhe nuk është i të gjithë vitit. Çka

do të thotë që aty ka një çalim të punës. Tani, o do penalizohet që nuk bashkëpunon me kolegët për të nxjerrë datën e gjyqin, o do penalizohet për standardin. T'i marrim me radhë çështjet me afat ligjor.

Cilat janë çështjet me afat ligjor që i janë llogaritur? Praktikisht, Gjykata e Apelit Administrativ funksionon si gjykatë apeli me juridiksion të përgjithshëm, atë që ligji nuk e lejon, por praktikisht për shkak të ngarkesës së punës dhe të volumit të çështjeve që çojnë në vendim unifikues dhe për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve, ata kanë krijuar shporta gjykimi, si kalendari i gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Pra gjyqtari e nxjerr çështjen sipas datës së regjistrimit. Në fakt, ligji thotë që ti duhet ta gjykosh brenda 30 ditëve, dhe ne jemi gjithmonë kundërshtuar për apelin e juridiksionit të përgjithshëm sepse sillej nga të gjithë aktorët dhe faktorët modeli i gjykatës së apelit administrativ. Megjithatë, për të mos penalizuar gjyqtarin i cili nuk ka faj që është krijuar ky "backlog", pra nuk është faji i gjyqtarit që ka 30.000 çështje gjykata e apelit administrativ, ne nuk ia kemi llogaritur në afat ligjor çështjet e shportës. Janë llogaritur si numër matematikor, por kur është bërë analiza logjike, është pasur parasysh çështjet e juridiksionit fillestar, që mirë okej, atë marrëdhënien e punës lëre edhe 3 vjet (që s'duhet ta lësh 3 vjet), se po të shikosh marrëdhënien e punës, këtu ka çështje të gjykuara brenda 2 muajve, ka çështje të gjykuara pas dy vjetëve (në tabelat statistikore). S'duhet ta lësh. Por ti e lë sepse s'ke çfarë bën. Edhe unë ndoshta ashtu do ta lija, se s'kam çfarë bëj, kam mund të gjykojë. Por kur vjen sigurimi i padisë, kur vijnë çështje që ligji të kërkon afat, reago dhe gjykoji. Kjo gjë ka bërë që në analizë të të dhënave të dali me 9 pikë (dhe është rritur me dy nivele). Ashtu siç kemi bërë edhe për gjyqtarët e shkallës së parë administrative e cila trajtonte (nuk duhet të përmend emër) kundërshtimin e veprimeve përmbarimore si një çështje normale dhe e gjykonte pas një viti e gjysmë. Pra kjo gjë duhet patjetër të thuhet, për të ruajtur të njëjtin standard.

E dyta, cili është mekanizmi që Këshilli mund të kontrollojë gjyqtarët? Çfarë iu bën Këshilli gjyqtarëve? Nuk do të gjykojë gjyqtari. Nuk vjen për procedim disiplinor. Nuk duhet të kemi ne një reagim për të nxitur gjyqtarin për të gjykuar dhe për të nxjerrë çështje? Unë mendoj që duhet te kemi. I vetmi mekanizëm në kushtet kur nuk kemi

miratuar ende “times frames” të reja ose kriteret sasior/kohor të shqyrtimit, është ky vlerësimi, të nxiten gjyqtarët, të nxiten që të jenë më produktiv. Qenia gjyqtar i shkëlqyer, siç është zonja {...}, ndoshta sot nuk është e mjaftueshme, në qoftë se gjyqtarja nuk është shumë produktive. Këtë kanë treguar të dhënat e saj statistikore për këtë vit, që është ndoshta gjyqtarja më e mirë në grupin e gjyqtarëve të gjykatës së apelit administrativ. Megjithatë, mua ndryshimi me 3 çështje nga një gjyqtar në tjetrin nuk më duket ndryshim thelbësor për ta veçuar.

Për sa i përket standardit minimal të afatit. Standardet minimale të afatit janë standarde orientuese që i vendos Këshilli. Nuk përcaktuam të reja dhe në metodologji thamë që do zbatojmë të vjetrat. Pse? Sepse gjyqtarët po vlerësoheshin për një periudhë që ato standarde kishin qenë në fuqi, e para. E dyta, nuk ishim në gjendje, në këtë gjendje që ndodhet sistemi ne të kishim një studim për të miratuar standarde të reja sasiore dhe kohore sepse standardi nuk miratohet, hajde bëjmë 9 muaj, por do studim, do të shikosh sjelljen e gjyqtarëve në kuadrin e një kapaciteti të plotë pune, që të vendoset një standard, që gjyqtari ta respektojë dhe t’i kërkosh llogari nesër-pasnesër. Këtë gjë nuk e bënim. Atëherë, menduam, çfarë standardi do aplikojmë ne për gjyqtarët e gjykatës së apelit administrativ në kushtet kur vendimi i KLD-së nuk e parashikon në mënyrë specifike por parashikon vetëm për gjykimin administrativ në shkallë të parë, për seksionin se më parë ka qenë seksion dhe nuk ishte krijuar gjykata administrative. Atëherë thamë që do zbatojmë atë kriter sasior cilësor më të favorshëm për gjyqtarin e gjykatës së apelit administrativ dhe thamë që në qoftë se gjyqtari i apelit administrativ e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, ajo nuk duhet t’i quhet çështje me afat ligjor por duhet t’i quhet çështje me standard minimal, që në llogaritjen dhe vlerësimin e tij ajo të gjykohej mundësisht brenda 6 muajve (standard orientues është). Hapësirën e vlerësimit Këshilli e ka më të madhe. Kemi shkuar ne këtu në standarde edhe me dy nivele. Por kur kemi shkuar? Kur gjyqtari kishte shpallur 800 vendime në vit; kur gjyqtari kishte shpallur 500 vendime në vit; kur gjyqtari kishte shpallur 300 vendime në vit. Pra kemi thënë që ky standardi i punës dhe kjo ecuri ndoshta e ka pasur të pamundur të respektojë standardin (se është standard orientues). Standardet orientuese nuk janë afate të arsyeshme. Kodi i

Procedurës Civile flet për afat të arsyeshëm 1-vjeçar, që gjyqtari nuk duhet ta tejkalojë kurrsesi. Standardi orientues është standard nxitës, e nxit gjyqtarin të jetë më produktiv, prandaj është komponenti i vlerësimit, se nëse nuk respektohet afati i arsyeshëm, është një gjykatë më e lartë që e vlerëson dhe nuk mund ta vlerësojë Këshilli.

Çfarë bie në sy nga statistikat e zonjës {...}. Në fakt mbi 100 çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi, çka tregon që ato kanë pasur një përgatitje paraprake nga ana e këshilltarit. Çështjet e juridiksionit fillestar janë 18, nga të cilat 1 është akt nënligjor. Kjo tregon që nuk është në kompleksitetin e tejskajshëm për të shkuar në rritje nivelesh deri në kufirin maksima, me këtë standard sasior pune që ajo ka.

Me të njëjtin arsyetim kam edhe për sa i përket propozimit për rritjen e pikëve në standardin minimal të afatit dhe kohën mesatare që i duhet gjyqtarit për të shqyrtuar një çështje sepse çështjet që janë përfshirë në standard dhe në kohë janë vetëm çështjet me standard jo çështjet me afat ligjor. Janë një grup shumë i vogël, ku kanë rezultuar të tejkaluara mbi 20%, por nga ana tjetër një normë likuidimi shumë e ulët e çështjes së gjyqtarit për atë vit.

Për sa i përket rendimentit, jam dakord që mund të shkojë edhe në një pikëzim maksimal, por kur gjyqtari ka tregues të tillë. Me 150 çështje nuk mund të shkojmë në rendiment 8 apo në rendiment 10. Kemi rritur 2 pikë rendimentit (sepse nuk ka gjykuar, nuk ka nxjerrë çështje).

Për sa i përket kohës mesatare të arsyetimit të vendimit, unë nuk dua të citoj asnjë gjë tjetër veçse propozimi i bërë nga zoti Hallunaj është në kundërshtim me rregulloren që ka miratuar Këshilli në metodologji, ku ne ia kemi rritur me një nivel vlerësimi. Shkuarja me 12 do shkonte në tre nivele vlerësimi, që nuk është aplikuar asnjëherë, për asnjë gjyqtar, madje edhe për ata gjyqtarë që kanë pasur vetëm dy për qind të çështjeve jashtë afatin për kohën mesatare.

Ndoshta fola pak më shumë, por në fakt në Komision ne kemi menduar gjatë pjesën e vlerësimit të standardit sasior dhe kohor, prandaj jam dakord me propozimin e relatores.

Naureda Llagami: Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Faleminderit Kryetare!

Unë ato që pata për t'i thënë i thashë, u thanë dhe i stërthamë dhe nuk dua të bie në përsëritje. Dua vetëm të sqaroj një fjalë që u tha me keqdashje, me qëllim, që njohjet personale nuk duhet të afektojnë. Në asnjë moment nuk thashë "njohje personale". Unë kam mbi 25 vjet në sistem dhe janë njohje profesionale, që për shkak të detyrës jemi njohur dhe njohim njëri-tjetrin, ashtu siç kam njohur edhe gjyqtaren për të cilën po diskutojmë. Kam qenë anëtar i KLD-së kur gjyqtari ka marrë pjesë në një provim për të cilin ka dalë në vendet fituese dhe është kualifikuar për të shkuar atje. Pra thjesht dua të sqaroj këtë momentin që s'janë njohjet personale, se nuk kanë qenë asnjë moment të punës time njohjet personale që kanë ndikuar në vendimmarrjet e mia. Ato që i kanë bërë, mund t'i kenë bërë për vete. Unë nuk e di. Por unë për vete nuk e kam vendos asnjëherë në këto standarde punën time. Ju faleminderit Kryetare!

Brikena Ukperaj: Mundet?

Ajo që unë thashë, kërkoj ndjesë nëse zoti Hallunaj e keqkuptoi, ajo që unë thashë është që gjyqtari vlerësohet mbi baza dokumentare. Se këtu janë ngritur edhe herë të tjera diskutime që, unë e njoh gjyqtarin, sepse kam punuar dhe ka këto tregues dhe është gjyqtar shumë i mirë. Këtë doja të thosha, që ne duhet të zhvishemi nga kjo gjë dhe ideja është që për të qenë sa më objektiv dhe për të ruajtur një standard, ta gjykojmë mbi këto gjëra dhe mbi këto prova që kemi. Absolutisht nuk kam pasur asnjë gjë dhe asnjë keqdashje ndaj propozimit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim një nga një të gjithë propozimet. Fillojmë me propozimin e parë të bërë nga zoti Hallunaj lidhur me respektimin e afatit ligjor, nga 9 pikë, gjyqtares t'i shtohen 3 pikë, që të shkojë në nivelin 12 pikë.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër, duke parashtruar arsyen që nuk ka fakte dhe prova për ndryshimin e këtij vlerësimi, përveçse kundërshtimi lidhur me metodologjinë të cilën ne e kemi aplikuar dhe po aplikojmë përditë. Nuk do ndryshojmë rregullat e lojës në mes. Duhet të zbatojmë të njëjtat standarde për të gjithë gjyqtarët që vlerësojmë.

Marçela Shehu: Dakord. Dua të bëj vetëm një koment të shkurtër. Ne kemi tashmë një vlerësim të gjyqtares për vitin 2013-2016, me një vlerësim total prej 397 pikësh dhe konkretisht, për "Aftësitë organizative të gjyqtares" u vlerësua në atë raport me 97 pikë. Nuk mendoj se gjyqtarja, me dashje, në vitin 2021 nuk ka gjykuar çështje dhe për këtë qëllim të vlerësohet me 74 pikë. Unë besoj dhe marrë të mirëqena të gjitha pretendimet e gjyqtares, sikurse edhe për të gjithë gjyqtarët e tjerë, që situata në të cilën ndodhen sot gjyqtarët nuk është një situatë normale, nuk është një situatë e zakonshme, ndaj edhe ne duhet të mirëkuptojmë dhe të tolerojmë për aq sa mundemi të gjitha pengesat që ata kanë në gjykimin e përvitshëm të çështjeve. Ndaj unë, edhe për kriteret e tjera, por për këtë kriter dakordësohem me propozimin me 12 pikë.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Meqenëse mu dha radha për të folur në këtë moment, por duke kursyer edhe kohën për shkak edhe të impenjimeve të tjera që ka kjo mbledhje për çështje të tjera, do flas për gjyqtaren dhe për pjesën e propozimeve që ka bërë kolegu. Fillimisht unë si gjyqtar referuar kritereve të vlerësimit që është bërë për gjyqtaren {...}, marr në konsideratë fillimisht si gjyqtar kriteret e aftësisë profesionale të gjyqtares, që për mua personalisht më rezultojnë që janë të larta, objektivisht të larta. Kjo na bën të mendojmë që kemi përpara një gjyqtare shumë të mirë, e njeh ligjin, ka një aftësi të shkëlqyer për të interpretuar normën në zgjidhjen e çështjes, është e qartë dhe koncize, është e kuptueshme në vendimmarrjet e saj, ka një strukturë të qëndrueshme në vendimin që

jep, ka cilësi të analizës, argumentim, ka referuar në jurisprudencën e gjykatave shqiptare, kushtetuese, Gjykatës së Lartë, ashtu edhe të gjykatave evropiane, Gjykatës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, njeh mirë institutet e të drejtës, identifikon marrëdhëniet shkak–pasojë; të gjithë këto komponentë për mua më çojnë në një përfundim që pavarësisht se nuk janë komponentë të cilët na çojnë në drejtimin a e ka zgjidhur objektivisht apo jo, sepse nuk jemi ne ata që e vlerësojmë meritën e vendimmarrjes, por janë komponentë që në mënyrë indirekte na bën të mendojmë që është një gjyqtare e aftë profesionalisht, shumë e aftë profesionalisht dhe zgjidhjet e çështjeve janë objektive. Përtej kësaj, dhe ky është një komponent i rëndësishëm që unë e vlerësoj në raport edhe me të gjithë komponentët e tjerë, sot më bëri përshtypje edhe prezantimi i saj, ishte i qartë, ishte bindës, ishte logjik, ishte me etikë, ishte vetëpërmbajtës, ashtu sikundër ne e duam një gjyqtar. Pra plotëson kushtet, kriteret për të qenë një gjyqtar dinjitoz në Republikën e Shqipërisë dhe ne kemi nevojë pikërisht për gjyqtarë të tillë. Këto janë elemente të cilat mua më bëjnë ta vlerësoj gjyqtarin se në çfarë kategorie përfshihet si gjyqtar referuar aftësive të tij profesionale. Duke marrë për bazë këto cilësi të gjyqtarit, unë shkoj bëj edhe vlerësimin e aftësive organizative të gjyqtares, të cilat, referuar të gjithë treguesve, nuk janë komponentë të cilët varen në mënyrë determinante nga vetë gjyqtari, nga mënyra se si e organizon ai punën. Pse? E para, aftësitë organizative lidhen me respektimin e afateve ligjore për ta zgjidhur çështjen brenda këtyre afateve ligjore, por ai është gjyqtar i gjykatës së apelit dhe çështjet nuk i gjykon vetëm si gjyqtar, i gjykon në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Pra i duhet fillimisht rënia në një dakordësi me kolegët e tjerë për të caktuar datën e gjyqit, për të caktuar datat e seancës së ardhshme, të cilat ndikojnë në afate tërësore të përfundimit të çështjes ligjore brenda kornizave që na njeh ligji.

Në këtë kuptim, mendoj që propozimi i bërë në tërësi nga kolegu, referuar aftësive organizative të gjyqtares, por edhe për komponentin e respektimit të afateve ligjore nga 9 në 12 pikë, është i arsyeshëm dhe unë dakordësohem me këtë propozim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kundër. Në fakt e kam bindje, se them që metodologjia që ne kemi pasur parasysh për të gjithë ngritjet në detyrë dhe mbaj parasysh Gjykatën e Lartë kur kemi pasur gjyqtarë që kanë kandiduar nga gjykatat e apelit, është e njëjta. Në qoftë se ne do kemi cilësi dhe kualifikim të ndryshëm të metodologjisë për raste të ndryshme, kjo më pas do na cenojë ose ndoshta është momenti që ne pse jo, ta rishohim metodologjinë për ta bërë më të veçantë sipas juridiksioneve. Por me të njëjtën metodologji, standardi që ne kemi pasur duhet të jetë i njëjtë.

(Nuk pranohet propozimi.)

Marçela Shehu: Më fal Kryetare!

Ishte gjyqtarja e parë e apelit administrativ që po vlerësonim.

Naureda Llagami: Po, kemi kaluar gjyqtarë të apelit të gjykatës së posaçme me të njëjtën metodologji.

Marçela Shehu: Jo të apelit administrativ.

Naureda Llagami: ...gjyqtarë të gjykatës së apelit të posaçëm, duke parë numrin e ngarkesës së çështjeve dhe gjyqtarë të apelit të përgjithshëm të Tiranës, po duke i parë numrin e ngarkesës së çështjeve.

Marçela Shehu: Jam dakord, por si gjyqtarja e gjykatës së apelit administrativ ishte gjyqtarja e parë që u vlerësua dhe u tha nga të gjithë që duhet të jemi të kujdesshëm, sepse do vendosim standarde. Pak më vonë do kemi gjyqtaren tjetër që do vlerësohet. Pra nuk po flisnim për emra dhe as për të ndryshuar metodologjinë. Ishte çështja e standardit dhe për të mirëkuptuar specifikën që ka gjykata e apelit administrativ dhe të gjitha rrethanat që kanë diktuar situatën e sotme. Nuk është faji i gjyqtarëve që nga sa gjyqtarë që kanë qenë, sot janë 5-6 me skemë delegimi, që janë shkarkuar gjyqtarë. Nuk është faji i gjyqtarëve. Pra ne duhet të mirëkuptojmë edhe natyrën e çështjeve dhe ngarkesën.

Naureda Llagami: Ideja ime është që do vazhdojmë me të njëjtën metodologji për sa kohë të gjithë juridiksionet i kemi bërë me të njëjtën metodologji.

Marçela Shehu: Secili juridiksion ka veçantitë e veta. Metodologjia na jep hapësirë që duke vlerësuar të gjithë rrethanat, ne të shkojmë nga një nivel vlerësimi në një nivel tjetër vlerësimi. Nuk po cenojmë standarde. Nuk po i ndryshojmë standardet. Por duke vlerësuar në tërësi situatën për secilin gjyqtar, për secilën gjykatë, ne arrijmë në një konkluzion.

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i dytë që bëhet fjalë nga 4, me 5 pikë, që shkon në 9? 4 me 1 pikë. (pra shkon në 5).

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk pranohet propozimi.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi tjetër që ka të bëjë, nga 6 pikë në 8 pikë.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk pranohet propozimi.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i fundit që është nga 6 pikë në 12 pikë.

Dritan Hallunaj: Atëherë, heq dorë nga propozimi për të rritur nga 6 në 12 pikë dhe propozoj nga 6 në 9 pikë. Pra rritje në një nivel. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, nga 6 në 9 pikë.

Irena Plaku: Ta marrë unë fjalën?

...se e ka rritur në një nivel po thotë. Për kohën e arsyetimit të vendimit.

Yllka Rupa: Koha mesatare e arsyetimit të vendimit është rritur një nivel, për shkak, sepse, metodologjia të lejon rritjen vetëm në një nivel, duke iu referuar 20% të koeficientit. S'kishte nevojë për koment prandaj.

(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Pranohet propozimi.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi që ka vetë relatorja, tek publikimet ligjore. Nga 0 pikë, vetë relatorja propozon rritjen 5 pikë.

Yllka Rupa: Unë e parashtrova tek vlerësimi i përgjithshëm dhe në këtë komponent është marrë në konsideratë publikimi dhe është rritur me 5 pikë dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit është ai që prezantova edhe me këtë rritje.

Naureda Llagami: Pra në tërësi kemi 379. Dhe 3 pikë që iu shtuan, 381.

Yllka Rupa: 379 është vlerësimi përfundimtar bashkë me rritjen e 5 pikëve tek komponenti “Publikimet ligjore”.

Naureda Llagami: Tani, e hedhim në votim bashkë me pikët që iu shtuan 3 pikë, që i thonë 382.

Atëherë, hedhim në votim raportin e vlerësimit me gjithë ndryshimet që pësoi. Në tërësi mbetet i njëjti nivel gradimi që është "Shumë mirë" dhe me 382 pikë.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord, duke qenë se u miratua edhe shtimi për tre pikët. Jam dakord me miratimin në tërësi, për sa kohë që u vendos nga shumica.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Pjesërisht dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitin 2021", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shumë mirë";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shumë mirë".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Naureda Llagami: Përpara se të kalojmë në çështjet e tjera, për shkak të një angazhimi që kam në këto momente, mbledhja të vijojë me zëvendëskryetarin. 5 minuta pushim që mbledhja të vijojë me zëvendëskryetarin.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.12.2022)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, " i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:23 dhe mbaroi në orën 15:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

10. Yllka Rupa ***(anëtare)***

Shënim: ***Zonja Llagami***, largohet nga mbledhja plenare pas trajtimit të pikës së dytë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vazhdimin e saj. Vazhdimi i mbledhjes drejtohet nga ***z. Rusi***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Genta.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, " i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Siç u njoftuat, mbledhja do të drejtohet nga ana ime.

Jemi tek pika 3 e rendit të ditës.

Për më tej, fjalën ia jap relatorit, z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Kryetar!

Unë po e mbledh në mënyrë të shkurtuar nëse edhe kolegët janë dakord për relacionin e radhës që i referohet rastit të komandimit të z. {...}, si Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë. Pasi kemi shpallur procedurat përkatëse për hapjen e vendit, për marrjen e kandidaturave, marrjen e opinionit, dërgimin Ministrisë së Drejtësisë ku në rastin konkret të ishte vetëm një kandidat i vetëm që kandidonte për vendin e shpallur si të komanduar nga Ministria e Drejtësisë. Në fund fare, Ministria e Drejtësisë ka shprehur dakordësinë e saj për pranimin në skemën e komandimit dhe fillimin e punës si Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë për zotin {...}.

Siç e kemi thënë edhe më përpara z. {...} plotëson kushtet ligjore dhe kriteret e kërkuara nga Ministria e Drejtësisë si një kandidat i mundshëm potencial në momentin që bëri kërkesën e tij, për t'u përfshirë në skemën e komandimit.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në nenin 54, pika 1 të ligjit nr. 96 të vitit 2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon një afat maksimal të komandimit deri në 5 vjet, afat për të cilin Ministria e Drejtësisë ka kërkuar në rastin konkret që afati të jetë i tillë, duke mbajtur në konsideratë se si rezultat i zbatimit të Ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë" në të ardhmen mund të ndodhemi në situatën e cenimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} gjatë kohëzgjatjes së periudhës së komandimit të z. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson që në kuptim të nenit 57, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në vendimin e komandimit të parashikohet edhe mundësia e ndërprerjes së komandimit përpara afatit kur një gjë e tillë do të jetë e domosdoshme për interesat më të larta të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor {...}.

Bashkëlidhur këtij relacioni ne paraqesim edhe projektvendimin përkatës për komandimin e z. {...} Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, projektvendim i cili përbëhet gjithsej nga 4 pika:

Në pikën e parë të vendoset sipas propozimit tonë komandimi i gjyqtarit z. {...} në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, për një afat deri në pesë vjet.

Afati i komandimit fillon më datë 1 janar të vitit 2023, duke iu referuar afatit ku ne do marrim vendimin në rastin e miratimit të propozimit tonë, i duhet një kohë e përshtatshme për të shkëputur marrëdhëniet dhe detyrimet që ai mund të ketë me gjykatën ku ai aktualisht ushtron funksionet.

Pika e tretë e projektvendimit i referohet që afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Pika e katërt, urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këto janë propozimet tona. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

Në vijim ka një koment përsëri nga zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Atëherë, edhe një herë, duke iu referuar edhe një herë projektvendimit të cilin unë sapo e propozova, bëj një propozim të ri, për shkak ndoshta të një gabimi material. Për pikën e parë të projektvendimit për komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit" në Ministrinë e Drejtësisë, për një afat, të hiqet fjala " deri". Pra për një afat pesëvjeçar. Afati i komandimit fillon më 1 janar 2023. Faleminderit!

Ilir Rusi: Keni diskutime për çfarë u parashtrua përfundimisht nga ana e relatorit?

(Nuk ka diskutime.)

Vazhdojmë me votimin e projekt-aktit.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për komandimin e z. {...} si Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, për një afat pesëvjeçar.

2. Afati i komandimit fillon më datë 1 janar 2023.

3. Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.12.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, të pasurisë dhe figurës, për ish-kancelarin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} z. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:23 dhe mbaroi në orën 15:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***

9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: ***Zonja Llagami***, largohet nga mbledhja plenare pas trajtimit të pikës së dytë të rendit të ditës dhe nuk merr më pjesë në vazhdimin e saj. Vazhdimi i mbledhjes drejtohet nga ***z. Rusi***.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI –INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Të tjerë: Genta.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, të pasurisë dhe figurës, për ish-kancelarin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} z. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës.

Për më tej fjalën ia jap relatores znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Është paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimi dhe relacioni shoqërues në lidhje me projektvendimin "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit të pasurisë dhe figurës për zotin {...}, ish-kancelar në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}".

Zoti {...} ka qenë kancelar në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} dhe për të Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procedurën e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, verifikimin e pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë, duke caktuar relatorin për çdo kandidat.

Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme.

Duke vlerësuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për ish-kancelarin në detyrë, z. {...}, është e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 424/2020, me datë 06.10.2022, çështja i është kaluar nga relatorja për shqyrtim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ndërkohë, pa u shqyrtuar çështja nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, kancelari në detyrë z. {...} më datë 17.10.2022 ka depozituar pranë Këshillit kërkesën për dorëheqje nga pozicioni i punës si kancelar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, për shkak të daljes fitues si kandidat në procedurë konkurrimi për pozicionin vakant për inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është në pritje të vendimit të emërimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës për dorëheqje të kancelarit, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, me vendimin nr. 457, datë 02.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, për shkak të dorëheqjes.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Sa më sipër, rezultatet e verifikimit në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës, nuk u bënë objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për shkak të pengesës procedurale të analizuar më poshtë, e cila afektonte vijueshmërinë e kësaj procedure verifikimi.

Neni 83, pika 1 i ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 "Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", lidhur me statusin e kancelarëve në detyrë parashikon se: "1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda gjashtë muajve nga krijimi i tij, verifikon plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe bën verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kancelarëve në detyrë".

Në pikën 1 të Kreut I, të vendimit 424/2020 parashikohet se qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror dhe të proporcionalitetit, për zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në bazë të pikës 2, ky vendim rregullon procedurat e verifikimit edhe për kancelarin në detyrë, status i dhënë për ta nga neni 83 i Ligjit 98/2016 i ndryshuar. Vijimi i kësaj procedure lidhet ngushtësisht me pasjen e këtij statusi jo vetëm në momentin e fillimit të procedurës së verifikimit, por edhe gjatë kësaj procedure. Në të kundërt nuk mund të realizohet qëllimi i procedurës së verifikimit, për kualifikimin e kancelarit e lejimin e pjesëmarrjes së tij në provimin e kualifikimit profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Në rastin konkret, z. {...} e ka humbur statusin e kancelarit në detyrë, për shkak se marrëdhënia e tij e punësimit ka përfunduar për shkak të ligjit, sikundër është përfundimi i marrëdhënies për shkak të dorëheqjes së tij. Në këto kushte ka rënë shkaku për të cilin kjo procedurë verifikimi ka filluar kryesisht dhe për këtë arsye, qëllimi i saj nuk

ekziston më. Zoti {...}, nuk ka më statusin e kancelarit në detyrë, status për shkak të së cilit ka filluar nga ana e Këshillit procedura administrative e verifikimit të pasurisë dhe figurës.

Këto rrethana fakti si më sipër, afektojnë ecurinë e kësaj procedure administrative, sipas parashikimeve të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, ku nën titullin: "Pamundësia në objekt apo qëllim", parashikohet se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur."

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, del e qartë se organi publik, i cili zhvillon procedurën, detyrohet të deklarojë përfundimin e saj pa vendim përfundimtar, në rastin kur konstaton ekzistencën e njërit prej rasteve të parashikuara nga neni 95 i K.Pr.A. Në këtë dispozitë përdoren terma ligjorë të përgjithshëm dhe të papërcaktuar siç janë "pamundësia", "objekti" dhe "qëllimi". Qëllimi i procedurës bëhet i pamundur, në rastin kur kryerja e një veprimi administrativ, ka humbur aktualitetin, për shkak të ndryshimit të rrethanave që mund të jenë faktike ose ligjore. Në rastin konkret humbja e statusit të kancelarit në detyrë për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës është një rrethanë ligjore që e bën të pamundur për t'u realizuar qëllimin e procedurës së filluar, çka passjell deklarimin e përfunduar të saj pa vendim përfundimtar.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, nga ana ime si relatore u vlerësua se procedura për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës ndaj z. {...} duhet të deklarohet e përfunduar, për arsye se ai nuk gëzon më statusin e kancelarit në detyrë, prandaj çështja iu parashtrua për vlerësim Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Në mbledhjen e datës 16.11.2022, Komisioni vendosi që kjo çështje t'i kalojë për shqyrtim mbledhjes plenare.

Bashkëlidhur është edhe projektvendimi përkatës.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime mbi projekt-aktin përkatës.

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, të pasurisë dhe figurës, për ish-kancelarin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} z. {...}".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. {...}, ish-kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ilir Rusi: Me këtë pikë të rendit të ditës ne i përfundojmë çështjet që janë me dyer të hapura. Vazhdojmë mbledhjen duke shqyrtuar çështjet të cilat janë me dyer të mbyllura. Në vijim mbledhja do të vijojë me dyer të mbyllura për faktin, sepse sipas rendit të ditës do të kemi kualifikimin/skualifikimin e kandidatëve për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2022-2023 dhe për shkak se ato përmbajnë të dhëna të karakterit sekret për shkak të pasurisë, figurës, atëherë kjo mbledhje do të bëhet me dyer të mbyllura. Faleminderit!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor